



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 671 Akti

Nr. 812 Vendimi
Tiranë, më 8.11.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj Kryesuese
Pamela Qirko Relatore
Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, në datën 7.11.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Lazer Çardaku**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisioneret Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe

Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar – ish-DSIK (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishtëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportet² e mbajtura për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore dhe ka dërguar një raport³ të hollësishtëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin i pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 18.10.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kritere për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 18.10.2024, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë nr. *** prot., datë 17.12.2019.

² (i) Raporti i AKSIK (ish-DSIK) nr. *** prot., datë 2.11.2017; (ii) raporti i AKSIK-së (ish-DSIK) nr. *** prot., datë 26.6.2023, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 4.7.2023.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 7.6.2023.

datën 21.10.2024, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 4.11.2024 (nëpërmjet rrugës elektronike, me *email*, dhe duke i depozituar në Komision, protokolluar me nr. *** prot., datë 4.11.2024).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 5.11.2024.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 5.11.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

19.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja (ish-DSIK) është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për

të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshi edhe interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të⁵.

22. Pas administrimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku.

22.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

23. Pasuria e llojit shtëpi banimi tre kate, me sipërfaqe banimi (trualli) 95 m², ndodhur në fshatin B, Njësia Administrative Sh, Bashkia Shkodër, aktualisht e pabanueshme, ende e

vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: "Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse".

⁵ Referuar nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

paregjistruar në ZVRPP-në Shkodër dhe e pavlerësuar, e ndërtuar në vitet '40, e trashëguar, në bashkëpronësi me prindërit, vëllain dhe motrat (me të gjithë pjesëtarët e familjes së origjinës)⁶.

23.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Dokumentacion justifikues jo i plotë në lidhje me banesën 3-katëshe në fshatin B – Sh , Shkodër, deklaruar se është përfituar me trashëgimi. Gjithashtu, është e paqartë nëse subjekti ka investuar në këtë banesë.

24. Pasuria e llojit tokë bujqësore arë me sipërfaqe dy dynym, ndodhur në fshatin B , Njësia Administrative Sh , Bashkia Shkodër, e trashëguar, e paregjistruar ende në ZVRPP-në Shkodër për shkak të mosndarjes së tokës sipas ligjit nr. 7501, por e ndarë sipas kufijve të vjetër, në bashkëpronësi me prindërit dhe vëllain⁷.

24.1 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. ZQRPP-ja nuk e konfirmon këtë pasuri, pasi ajo nuk është regjistruar.

Deklarimi i këtyre pasurive ndër vite në ILDKPKI

25. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se:

25.1 Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim e vitit 2003 (depozituar në ILDKPKI në datën 19.3.2004), ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e llojit: (i) shtëpi banimi ndodhur në fshatin B, D , fituar me trashëgimi, dhe se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie; (ii) tokë bujqësore ndodhur në fshatin B, D , fituar me trashëgimi, dhe se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie.

25.2 Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim DIPP) e vitit 2004, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar pasuritë e llojit: (i) shtëpi banimi në fshatin B, D , 3-katëshe, e ndërtuar në vitin 1950, trashëguar nga gjyshi P.Ç , dhe se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie; (ii) tokë bujqësore në fshatin B, D , e trashëguar, dhe se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra mbi mënyrën e krijimit të këtyre pasurive

26. Ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër⁸ nuk konfirmon regjistrimin e këtyre pasurive në emër të subjektit të rivlerësimit.

27. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së⁹, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këto pasuri¹⁰, Komisioni konstaton se Njësia Administrative Sh , Bashkia Shkodër, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, lindur në fshatin B (N), banues në lagjen “****”, rruga “****”, qyteti Shkodër,

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, lëshuar nga Njësia Administrative Sh .

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentin vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, lëshuar nga Njësia Administrative Sh .

⁸ Referojuni shkresës së ZVRPP-së Shkodër me nr. *** prot., datë 7.8.2017, ndodhur aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Referojuni dokumentit të depozituar nga subjekti (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së), vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, lëshuar nga Njësia Administrative Sh .

¹⁰ Referojuni dokumentit vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, lëshuar nga Njësia Administrative Sh , përcjellë Komisionit me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 12.8.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.8.2024).

ka qenë banor në fshatin B, ish-komuna Sh , deri në vitin 1993 dhe se në këtë fshat ka një banesë trekatëshe, aktualisht e pabanueshme, pasi e gjithë familja e tij, babai, vëllai etj. janë me banim në qytetin e Shkodrës. Po kështu, sipas vërtetimeve të lëshuara nga kjo njësi administrative, familja e subjektit ka tokë bujqësore, sipërfaqe kullosore, të pyllëzuar me dushk, gështenja etj. Gjithashtu, referohet se toka në Njësinë Administrative Sh (ish-komuna Sh) nuk është ndarë sipas ligjit nr. 7501, por ajo administrohet sipas kufijve të vjetër të trashëguar brez pas brezi. Po sipas këtij vërtetimi, evidentohet se aktualisht familja e subjektit, babai, vëllai, motrat, kanë para shtëpisë në fshatin B një sipërfaqe toke rreth dy dynym – të llojit arë dhe se toka, banesat etj., në këtë njësi administrative në përgjithësi janë të paregjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

28. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni¹¹, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dërgoi të dhëna/dokumentacion mbi gjendjen familjare të subjektit në datën 1.8.1991, nga ku duket se sipas certifikatës së lëshuar nga zyra e gjendjes civile të Njësisë Administrative Sh , Bashkia Vau Dejës, në përbërjen familjare të tij ka qenë bashkëshortja dhe djali, B.Ç .

29. Pasi Komisioni i kërkoi¹² të japë detaje mbi mënyrën e fitimit të këtyre pasurive (të drejtat reale), të saktësojë pjesën takuese të cilat ai zotëron mbi to, si dhe të deklarojë nëse ka kryer investime mbi këto pasuri, e nëse po, të specifikojë natyrën dhe vlerën e investimit të kryer, duke evidentuar më vete për çdo vit kalendarik shpenzimet e kryera dhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për mbulimin e tyre, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se shtëpia e banimit e ndodhur në fshatin B është ndërtuar shumë vite më parë nga familja e tij, e trashëguar, e braktisur pas viteve '90 dhe se aktualisht është në gjendje të amortizuar dhe është tërësisht e pabanueshme. Sa i përket kësaj godine, por edhe tokës bujqësore, deklaroi se këto pasuri vazhdojnë të jenë të paregjistruara (toka për shkak të mosndarjes sipas ligjit nr. 7501), sepse i ka në bashkëpronësi me nënën, vëllain dhe motrat (pasi babai i ka ndërruar jetë në vitin 2023) dhe se pjesa takuese që ai zotëron mbi to është 20%.

29.1 Në mbështetje të deklarimeve të tij – pas kërkesës së bërë nga Komisioni – subjekti ka depozituar edhe disa foto, për të cilat referon se janë të godinës së banimit në fshatin B, D , Shkodër, të deklaruar si pasuri e familjes së tij, por edhe foto me pamje të tokës bujqësore të pretenduar, nga ku duket se shtëpia është në gjendje të pabanueshme – pjesërisht e rrënuar, pra se nuk ka pasur investime të kryera mbi të.

30. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratat e interesave privatë të depozituara në vite në ILDKPKI – në lidhje me pjesën takuese potenciale të tij mbi pasuritë objekt vlerësimi, por se, gjithsesi, nuk ka dyshime të tjera sa i takon mënyrës së krijimit të banesës/godinës trekatëshe të ndodhur në fshatin B, D , Shkodër dhe në lidhje me tokën bujqësore të deklaruar.

31. Në këtë kontekst, në vlerësim edhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit mbi këtë konstatim, trupi gjykues vlerëson se pasaktësia në deklarin e pjesës takuese mbi këto pasuri në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të viteve 2003 dhe 2004 është e karakterit formal dhe pa pasoja, dhe si e tillë, nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimit kalimtar.

¹¹ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 5.8.2024.

¹² Pyetësi nr. **, i dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

32. Pasuria e llojit apartament banimi me sipërfaqe 73 m², ndodhur në lagjen “****”, Shkodër (z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***), regjistruar me aktin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 23.8.1999, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me vlerë 200,000 lekë. Referon se kjo pronë është rivlerësuar sipas ligjit në datën 21.3.2012, në vlerën 4,036,900 lekë¹³.

32.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet prej të ardhurave nga paga për vitet 1982 – 1992, si specialist në Kooperativën Bujqësore Sh , në detyrën e hetuesit dhe më pas prokurorit në Pukë, nga viti 1992 deri në vitin 1999, si dhe nga kursimet e pagës së bashkëshortes si mësuese.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

33. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se:

33.1 Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim e vitit 2003 (depozituar në ILDKPKI në datën 19.3.2004), ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi (2+1) me sipërfaqe 75 m², me vlerë 2.4 milionë lekë, ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, nr. *** (parafabrikat), blerë në vitin 1999, me burim të ardhurat/kursimet nga pagat. Deklaron se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie.

33.2 Në DIPP-në e vitit 2004, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi 2+1 me sipërfaqe banimi 75 m², blerë në vitin 1999, me adresë lagjja “****”, rruga “****”, nr. ***, me vlerë 2,000,000 lekë. Deklaron se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie.

33.3 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rivlerësimin e pasurisë shtëpi banimi në pallat, me sipërfaqe 73 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, datë 21.3.2012. Vlera 4,036,400 lekë. Deklaron se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

34. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Deklarim i pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 73 m² në Shkodër, në vitin 1999, pasi në deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar vlera 200,000 lekë, kurse në deklaratën e interesave privatë ndër vite është deklaruar vlera 2,400,000 lekë dhe 2,000,000 lekë. Gjykohet vlerë e ulët e blerjes së këtij apartamenti në vitin 1999, referuar kontratës nr. ***, datë 23.8.1999.

35. Pasuria e llojit ndërtesë me sipërfaqe 22.9 m² së bashku me truallin, ndodhur në lagjen “****”, Shkodër (z. k. ***, nr. pasurie ***, faqe ***), në bashkëpronësi me bashkëshorten, regjistruar me leje legalizimi. Subjekti ka deklaruar se kjo ndërtesë është ngjitur me pallatin e banimit (kati i parë) dhe se është bërë para vitit 1999, duke u blerë në atë gjendje së bashku me banesën e referuar si më sipër (hyrjen e apartamentit), në datën 23.8.1999 (përfshirë në vlerën e blerjes së apartamentit)¹⁴.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) shkresë e ZVRPP-së Shkodër nr. *** prot., datë 11.10.2016 (ku referohet informacion mbi pasurinë e paluajtshme); (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 15.1.2009; (iii) kartelë e pasurisë së paluajtshme; (iv) hartë treguese të regjistrimit.

¹⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) shkresë e ZVRPP-së Shkodër nr. *** prot., datë 11.10.2016 (ku referohet informacion mbi pasurinë e paluajtshme), si dhe në aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dokumentet si vijon: (ii) vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 18.7.2012; (iii) hartë treguese të regjistrimit të pasurisë; (iii) leje legalizimi nr.

35.1 Në vijim të deklaramit të tij, subjekti ka evidentuar se me hyrjen në fuqi të ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje është aplikuar për legalizimin e shtesës dhe se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 18.7.2012, është regjistruar në pronësi me bashkëshorten. Vlera e investimit është vlerësuar 670,764 lekë.

36. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar legalizimin e shtesës së pallatit me sipërfaqe 22.9 m², sipas dokumentit vërtetim hipotekor nr. ***, datë 19.6.2012, me vlerë 670,764 lekë.

37. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Mosdeklarim i shtesës prej 22.9 m², si dhe vlerës së investuar, në adresën lagjja “****”, Shkodër, në deklaratat e interesave privatë 2003 – 2006.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra mbi këto pasuri (apartamentin + shtesën anësore)

38. Ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër¹⁵ konfirmon se nga kërkimi i kryer në sistemin e ri elektronik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme IPS, si dhe nga programi i pasurive, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë këto pasuri: (i) pasurinë nr. ***, ndodhur në z. k. ***, e llojit truall, me sipërfaqe totale pasurie 22.9 m², sipërfaqe trualli 22.9 m² dhe sipërfaqe ndërtese 22.9 m²; (ii) pasurinë nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, e llojit apartament, me sipërfaqe totale pasurie 73 m².

39. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këto pasuri, Komisioni konstaton se:

39.1 Në datën 23.8.1999, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë¹⁶ pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 73 m², të ndodhur në lagjen “****”, rruga “ ****”, pallati nr. ***, Shkodër, për vlerën 200,000 lekë.

39.2 Në datën 6.9.2006, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet formularit “Shtojca A” – vetëdeklarim për legalizimin e shtesës (nr. *** prot.), ka deklaruar shtesë pallati me sipërfaqe 24 m², në apartamentin e banimit me sipërfaqe 73 m², të ndodhur në lagjen “****”, rruga “ ****”, pallati nr. ***, Shkodër.

***, datë 16.5.2012; (iv) foto digjitale, planimetria dhe genplani i objektit; (v) dokumentacion mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimin informal (formular pagese, mandatpagesë etj.).

¹⁵ Referojuni shkresës së ZVRPP-së Shkodër nr. *** prot., datë 7.8.2017 (ndodhur në aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁶ Akt shitblerjeje pronë pasuri e paluajtshme – apartament banimi, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.1999, redaktuar nga noteri publik, znj. V.S.

39.3 Në datën 9.5.2012, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore¹⁷, për truallin në të cilin ishte ndërtuar shtesa pa leje e vetëdeklaruar, me sipërfaqe 22.9 m².

39.4 Në datën 16.5.2012, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër ka lëshuar lejen e legalizimit¹⁸ për shtesën e deklaruar nga subjekti, me të dhënat: (i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore 22.9 m²; (ii) sipërfaqja e ndërtimit 22.9 m², nga të cilat për banim 22.9 m², pasi më parë kishte kryer pagesën përkatëse në shumën 45,800 lekë (datë 25.4.2012).

40. Rezulton se, bazuar në transaksionet dhe dokumentacionin e referuar si më sipër – pasuritë objekt vlerësimi janë regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

41. Pasi Komisioni i kërkoi¹⁹ të japë shpjegime mbi mospërputhjet e evidentuara në deklarinimin e bërë ndër vite dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* mbi vlerën e apartamentit të ndodhur në lagjen “*** ”, Shkodër, si dhe të konfirmojë çmimin e blerjes së këtij apartamenti, duke deklaruar nëse ai përfshin edhe shtesën anësore, apo nëse ka paguar vlerë tjetër për të, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se vlera e banesës 2.4 milionë etj., është deklaruar në referim të çmimeve të tregut dhe nuk ka lidhje me vlerën e çmimit të blerjes së saj. Një fakt i tillë është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë në formë elektronike, në vitin 2021. Gjithashtu ka deklaruar se ndërtimi me sipërfaqe 22.9 m² ka qenë shtesë e banesës 2+1, apartamentit të blerë prej tij në datën 23.8.1999, dhe se nuk është ndërtuar prej tij, por nga shitësi S. D., përpara se ai të blinte apartamentin²⁰.

42. Ndërkohë, i pyetur më parë nga ILDKPKI-ja²¹ në lidhje me shtesën e apartamentit, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se shtesa ka qenë e ndërtuar rreth vitit 1998 dhe *vlera e blerjes 2,400,000 lekë të apartamentit ka përfshirë edhe këtë shtesë*.

43. Nisur nga mospërputhjet e evidentuara në deklarinimet e subjektit, por edhe në referim të çmimeve mesatare të tregut të lirë të kohës, duket se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes datë 23.8.1999 nuk përfaqëson çmimin real të blerjes së këtyre dy pasurive.

44. Referuar VKM-së nr. 214, datë 28.4.1999, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, vlera mesatare e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 1998, për rrethin e Shkodrës, ka qenë 23,400 lekë/m².

44.1 Në mungesë të të dhënave zyrtare në lidhje me vlerën mesatare të tregut të lirë të apartamenteve për vitin 1999, për rrethin/qytetin e Shkodrës, paraprakisht vlerësohet se vlera mesatare e blerjes së një apartamenti prej 73 m² ka qenë 1,708,000 lekë ($73 \text{ m}^2 * 23,400 \text{ lekë/m}^2 = 1,708,000 \text{ lekë}$).

¹⁷ Kontrata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. O.K .

¹⁸ Leja e legalizimit nr. ***, datë 16.5.2012.

¹⁹ Pyetësori nr. ***, i dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

²⁰ Në mbështetje të deklarinimeve të tij në lidhje me faktin se në momentin e blerjes së apartamentit 2+1 me sipërfaqe 73 m² – ka qenë edhe shtesa e ndërtimit në pjesën e pasme të pallatit, subjekti ka depozituar disa deklarata noteriale – për të cilat referon se janë bërë nga banorë të tjerë të këtij pallati që kanë banuar aty para blerjes nga ana e tij të kësaj pasurie.

²¹ Referojuni dokumentit procesverbal “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarinimit të pasurisë”, datë 15.1.2016, përcjellë Komisionit me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 12.8.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.8.2024).

45. Duket se vetë subjekti ka pranuar se çmimi real i blerjes së apartamentit + shtesën ka qenë në shumën 2,400,000 lekë, kjo bazuar në deklaratimet e bëra prej tij mbi këto pasuri në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim e vitit 2003, shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurisë”, datë 15.1.2016, por edhe në deklarinimin e bërë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë në format elektronik për subjektet në funksion, e vitit 2021²².

45.1 Kështu, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ²³, subjekti ka referuar se në deklaratimet e tij në deklaratat periodike vjetore ka pasqyruar vlerën e tregut të apartamentit + shtesën. Por, Komisioni vëren se kemi të bëjmë me deklarime kontradiktore të tij, pasi vlera prej 2.4 milionë lekësh, e deklaruar prej tij në vitin 2003, mund të jetë e përafërt me vlerën e tregut të kësaj pasurie për vitin e deklaratimit apo momentin e deklaratimit (dorëzuar deklarata datë 19.3.2004), por nuk përfaqëson vlerën e tregut të kësaj pasurie për vitin 2021.

45.2 Nga ana tjetër, nëse sipërfaqja e kësaj pasurie do të vlerësohej së bashku me shtesën në referim të VKM-së së dalë në vitin 1999 për EKB-në (referuar më sipër), vlera e tregut të saj do të ishte në shumën 2,244,060 lekë ($95.9 \text{ m}^2 * 23,400 \text{ lekë/m}^2 = 2,244,060 \text{ lekë}$), vlerë e cila duket e përafërt me deklaratimet e bëra nga subjekti.

46. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, si dhe në vlerësimin e bërë nga Komisioni bazuar në vendimin e dalë për EKB-në për vitin 1999, për efekt analize paraprakisht u përllogarit se vlera totale e blerjes së këtyre pasurive (apartamentit + shtesës) ka qenë 2,400,000 lekë.

46.1 Për sa më sipër, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit dhe personit të lidhur, bashkëshortes së tij, për pagesën në datën 23.8.1999 të çmimit të përllogaritur prej 2,400,000 lekësh – për blerjen e pasurive objekt vlerësimi, nga ku duket se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin në datën 23.8.1999 të çmimit të vlerësuar për blerjen e apartamentit + shtesës anësore.

47. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi konstatimet e bëra për pasuritë objekt vlerësimi dhe rezultatin e analizës financiare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

48. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij dhe depozitoi prova të reja shtesë mbi gjetjet/konstatimet e bëra nga Komisioni në lidhje me pasuritë objekt vlerësimi, duke parashtruar sa më poshtë vijon:

48.1 *Së pari*, deklarimi i tij i vitit 2003 i përket vlerës së tregut për dy pasuritë, ku në vlerësimin e tij apartamenti me sipërfaqe 22.9 m² mund të kishte një vlerë tregu prej 2,000,000 lekësh dhe shtesa prej 400,000 lekësh dhe se, për këtë arsye, në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar vlerën e tregut të këtyre dy pasurive, në shumën totale 2,400,000 lekë. Ndërsa, në vitin 2004 referon se ka deklaruar apartamentin në vlerën e tregut 2,000,000 lekë, por duke mbajtur në konsideratë

²² Deklaratë e përcjellë në Komision me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 12.8.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.8.2024).

²³ Në përgjigje të pyetësorit nr. *** , të dërguar nga Komisioni.

vetëm pasurinë e regjistruar, ndërsa për shtesën, për sa kohë nuk kishte dokumentacion justifikues ligjor, kishin orientim se nuk duhej deklaruar.

48.2 *Së dyti*, deklararon se këto dy pasuri (apartamenti dhe shtesa) kanë pasur vlerë tregu nga banka në vitin 2021, në shumën 2,400,000 lekë, duke pretenduar se rreth 20 vite më vonë nga vlerësuesit e BKT-së kjo pasuri është vlerësuar në shumën 2,400,000 lekë, për kredinë e marrë pranë kësaj banke, me qëllim blerjen e apartamentit nga djali E.Ç , për pjesën takuese në shumën 3,063,000 lekë²⁴. Në këtë kuptim, subjekti ka argumentuar se vlera e tregut e pretenduar prej tij në vitin 2003, në shumën 2,400,000 lekë, konfirmohet në të njëjtën vlerë tregu edhe pasi kanë kaluar 20 vite, duke deklaruar se edhe pse mund të duket e habitshme vlera e tregut për apartamentet parafabrikat, sidomos për ato të ndodhura në katin e parë, nuk kanë interes dhe nuk kanë pasur në vite rritje të vlerës së shitjes së apartamenteve, në ndryshim të theksuar me apartamentet e reja të ndërtuara me strukturë tullë.

48.3 *Së treti*, sa i përket çmimit të vlerësuar nga Komisioni për blerjen këtyre dy pasurive, subjekti ka pretenduar se vlera mesatare e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 1998, sipas VKM-së nr. 214, datë 28.4.1999, i përket çmimit të apartamenteve të reja dhe jo apartamenteve parafabrikat, që nuk kishin interes të bliheshin në atë kohë. Gjithashtu, subjekti ka referuar faktin se kjo metodikë e Komisionit nuk është zbatuar në ato vite, pasi pretendon se po në vitin 1999 ai ka shitur apartamentin me sipërfaqe 48.5 m², në shumën 200,000 lekë, ndërsa sipas Komisionit duhet ta shiste 1,134,900 lekë (48.5 m² x 23,400 lekë/m²). Në vijim të shpjegimeve të tij, subjekti referon se, kur ka deklaruar vlerën e tregut në vitin 2003 të apartamentit dhe shtesës, ka pasur në konsideratë vlerën e tregut për metër katror që shitej në Shkodër. Ndërsa, sipas tij, kërkesa për parafabrikat ka qenë shumë e ulët, për shkak si të cilësisë, por edhe të vendndodhjes së apartamentit afër stacionit hekurudhor.

48.4 *Së katërti*, subjekti ka deklaruar se në vitin 1999 ai, së bashku me familjen, shitën apartamentin me sipërfaqe 48.5 m² në fshatin O, 8 kilometra larg qytetit të Shkodrës, në shumën 200,000 lekë, për të blerë në po të njëjtën vlerë një apartament në katin e parë, parafabrikat, por me sipërfaqe më të madhe, dhe se shtesa prej 22.9 m² nuk ishte e përfunduar dhe nuk ishte e banueshme, por është bërë e banueshme prej tij.

48.5 *Së pesti*, subjekti parashtron se Komisioni nuk ka analizuar vlerën e blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme nga shitësit S e M. D, për të analizuar më pas çmimin e blerjes prej tij. Kështu, subjekti pretendon se nëse i referohemi praktikës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shitësit S dhe M.D e kanë blerë apartamentin nga Enti Kombëtar i Banesave e në të njëjtën ditë ia shesin atij (datë 23.8.1999), në shumën 41,600 lekë. Në vijim, evidenton faktin se shitësi ka fituar nga shitblerja e pasurisë së paluajtshme dhe se ai vetë nuk e ka blerë më pak se vlera e mëparshme e shitjes, pra se transaksioni ka qenë me fitim, duke mbajtur në konsideratë edhe materialet që janë hedhur për shtesën e objektit.

48.6 *Së gjashti*, subjekti ka evidentuar disa vendime të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku shprehen mbi fuqinë juridike të akteve zyrtare, duke referuar edhe nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i

²⁴ Në mbështetje të deklarimeve të tij ka depozituar si prova të reja kontratën e kredisë bankare dhe kontratën e hipotekimit për kredinë e marrë në BKT nga djali i tij, E.Ç .

cili parashikon shprehimisht se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”. Në këtë kontekst, subjekti argumenton se akti i shitjes i hartuar nga noteri, i cili konsiderohet një person që ushtron veprimtari publike, ka fuqi të plotë provuese për efekt të këtij procesi.

48.7 Në përfundim të shpjegimeve të dhëna lidhur me këto dy pasuri, subjekti ka pretenduar se blerja e apartamentit me sipërfaqe 73 m² duhet të analizohet në vlerën e blerjes sipas kontratës, në shumën 200,000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të kryer deri në datën 23.8.1999 duhet të përfshihet si e ardhur shuma prej 200,000 lekësh nga shitja e apartamentit në O.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm

49. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi – trupi gjykues argumenton sa më poshtë vijon:

49.1 Komisioni konstaton se vetë subjekti i rivlerësimit ka pranuar se vlera e tregut e dy pasurive objekt vlerësimi – të paktën në momentin e deklarimit të parë të bërë prej tij në ILDKPKI (në fillim të vitit 2004) – ka qenë prej rreth 2,400,00 lekësh, po aq sa është vlerësuar nga Komisioni në analizën paraprake financiare.

49.2 Nga ana tjetër, megjithëse subjekti ka pretenduar se këto dy pasuri (apartamenti dhe shtesa anësore) janë vlerësuar nga BKT-ja në vitin 2021, në shumën 2,400,000 lekë, pasi janë lënë si garanci në favor të bankës, Komisioni vëren se sipas kontratës së kredisë²⁵ së lidhur me këtë bankë shuma prej 2,400,000 lekësh përfaqëson vlerën e kredisë së akorduar në favor të subjektit dhe personit të lidhur, dhe jo vlerësimin e pasurisë të lënë si kolateral me qëllim sigurimin e saj. Po ashtu, nga analizimi i kontratës së hipotekës²⁶ të lidhur me këtë kredi, në nenin 2.1 të saj evidentohet se vetëm pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 73 m² është vendosur si garanci për sigurimin e kredisë. Parë në këtë optikë, duket qartë se vetëm vlera e apartamentit ka shërbyer si garanci për mbulimin e shumës së marrë kredi, prej 2,400,000 lekësh. Vlen të theksohet këtu se, përgjithësisht, sipas politikave të bankës nuk jepet si kredi bankare kundërvlehtë e plotë e shumës së pasurisë të vlerësuar, të lënë kolateral. Gjithsesi, subjekti nuk ka paraqitur raportin e vlerësimit të pasurisë së lënë garanci për bankën, ku evidentohet qartë vlera e përlllogaritur nga kjo e fundit për pasurinë e lënë kolateral. Për më tepër, rezulton se apartamenti është rivlerësuar sipas ligjit në datën 21.3.2012, në vlerën 4,036,900 lekë, ndërsa shtesa në momentin e kryerjes së procedurave të legalizimit (viti 2012) për efekt të pagimit të taksave përkatëse është vlerësuar nga organet kompetente në vlerën 670,764 lekë.

49.3 Në vijim të arsyetimit, Komisioni sjell në vëmendje se deklarata e interesave privatë/periodikë vjetorë për subjektet në funksion e vitit 2021 (në format elektronik) është e ngjashme me deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim e vitit 2003 (depozituar në ILDKPKI në datën 19.3.2004), pasi kërkon prej subjekteve deklaruere deklarimin e të gjitha

²⁵ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2021, redaktuar nga noteri publik znj. M. Xh. D .

²⁶ Kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2021, redaktuar nga noteri publik znj. M. Xh. D .

pasurive gjendje deri në datën 31.12.2021 dhe jo shtesat/pakësimet nga viti paraardhës deklarues. Parë në këtë këndvështrim, ky deklaram i bërë në deklaratën e vitit 2021, i vlerësuar në raport me deklarimin e bërë nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë dhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI nëpërmjet procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë”, datë 15.1.2016, krijon bindjen te trupi gjykues se vlera e blerjes së këtyre dy pasurive është 2.4 milionë lekë.

49.4 Edhe sa i përket pretendimit të subjektit se vlera mesatare e apartamenteve për vitin 1998, sipas VKM-së nr. 214, datë 28.4.1999, i përket çmimit të apartamenteve të reja dhe jo apartamenteve parafabrikat, që nuk kishin interes të bliheshin në atë kohë, Komisioni sjell në vëmendje se vetë vendimi përcakton vlerën mesatare të tregut të lirë të shitjes së apartamenteve, pa ndarë nëse bëhet fjalë për ndërtime të reja apo ekzistuese e, për më tepër, kjo vlerë sipas këtij vendimi përfaqëson vlerën mesatare të tregut të lirë për rrethin e Shkodrës, ku përfshihen edhe zonat rurale.

49.5 Në vijim të shqyrtimit të prapësimeve të subjektit, ku referohet se kjo pasuri është blerë prej tij në të njëjtën ditë që EKB-ja ia ka shitur palës shitëse me vlerë 41,600 lekë, pra me çmim më të ulët nga sa e ka blerë ai, Komisioni sjell në vëmendje se vetë subjekti ka deklaruar se shtesa anësore është ndërtuar nga shitësit që në vitin 1998, pra potencialisht ata kanë qenë përdorues të kësaj pasurie para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me EKB-në. Megjithëse kontrata e shitblerjes me EKB-në nuk përcakton rrethanat/detajet se si e ka përfituar këtë pasuri pala blerëse, mund të supozohet se ata kanë qenë në marrëdhënie qiraje me EKB-në për këtë banesë, apo se e kanë përfituar në ndonjë formë tjetër (si p.sh. me privatizim/për shkak se kanë qenë të pastrehë etj.), duke evidentuar këtu se vetë çmimet e aplikuara nga EKB-ja për shitjen e apartamenteve nuk përfaqësojnë vlerën e tregut të tyre.

49.6 Në lidhje me pretendimin e subjektit se e njëjta metodikë do të duhej të zbatohet edhe për shitjen e apartamentit prej tij në O, trupi gjykues, në vlerësim përfundimtar – bazuar në dokumentacionin e administruar – çmon se kjo pasuri është shitur në vitin 2005, pra se nuk ndikon në analizën financiare në lidhje me mundësinë e subjektit për blerjen e apartamentit + shtesës anësore në vitin 1999. Për më tepër, në rast të kundërt, subjekti do të gjendej në kushtet e deklarimit të rremë të çmimit të shitjes së kësaj pasurie.

49.7 Gjithashtu, trupi gjykues argumenton se bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁷, pavarësisht se elementet, të drejtat dhe detyrimet e kontratës së shitjes në tregun e lirë imponohen nga vullneti i palëve kontraktore në përcaktimin e tyre, ky vullnet nuk është i pakufizuar, si në përcaktimin e çmimit dysheme, i cili, për shkak të politikave fiskale, parashikohet në akte nënligjore, po ashtu edhe sa i përket vendosjes së çmimeve që dukshëm tejkalojnë çmimin real të përcaktuar po në akte nënligjore, siç janë edhe ato të parashikuara në udhëzimet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e vlerës mesatare të shitjes së banesave në tregun e lirë.

50. Nisur nga të gjitha rrethanat e evidentuara, si dhe në mbështetje të arsytimit më sipër, Komisioni vlerëson se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së datës 23.8.1999 nuk përfaqëson çmimin real të shitblerjes së dy pasurive objekt vlerësimi. Në këtë kontekst, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën

²⁷ Referojuni vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 13 (JR), datë 4.4.2023 (shihni paragrafët 15.6 dhe 15.7 të këtij vendimi).

e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, lidhur me çmimin e blerjes së pasurive të llojit apartament banimi me sipërfaqe 73 m² dhe shtesës anësore me sipërfaqe 22.9 m², duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

51. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen deri në datën 23.8.1999 të pagesës për blerjen e apartamentit dhe shtesës anësore – pasuri këto të ndodhura në qytetin e Shkodrës, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1992 – 23.8.1999	Vlerat në lek
A) PASURI	2 400 000
Apartament me sip. 73 m ² + shtesa 22.9 m ² , ndodhur në Shkodër	2 400 000
Ndryshim likuiditeti	0
B) Detyrim	0
C) Pasuri neto (A-B)	2 400 000
D) Të ardhura	1 566 628
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	1 504 948
Të ardhura nga paga/pagesa e papunësisë nga bashkëshortja e subjektit	61 680
E) SHPENZIME	1 033 974
Shpenzime jetike	1 033 974
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1 867 347

52. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

53. Pasuria e llojit automjet, i markës “**”, tip “****”, me targë AA ***, vit prodhimi 2005,** blerë në datën 16.9.2015 nga djali i subjektit, B.Ç , në vlerën 3,000 euro.

53.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjeteve të mëparshme, konkretisht: (i) shuma prej 150,000 lekësh, përfituar nga shitja në datën 1.7.2015 e automjetit tip “****”, vit prodhimi 1999, me targë AA ***; (ii) shuma prej 4,500 euro, përfituar nga shitja e automjetit tip “****”, me targë AA ***; (iii) shuma prej 300,000 lekësh, përfituar nga shitja në datën 28.10.2013 e automjetit tip “****”, vit prodhimi 1996, me targë AA ***.

53.2 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë, të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, djali B.Ç , kanë deklaruar blerjen e automjetit të markës “****”, tip “****”, me targë AA ***, vit prodhimi 2005, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.9.2015, me vlerë 3,000 euro, regjistruar në emër të shtetasit B.Ç .

54. Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

55. DPSHTRR-ja²⁸ informon se djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA ***. Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja, konstatohet se: (i) prej datës 15.1.2010, shtetasi I.K e ka pasur në pronësi këtë automjet në shtetin italian; (ii) në datën 31.8.2015, ky shtetas i ka dhënë tagra të plota mbi këtë pasuri personit të lidhur, djalit të subjektit, B.Ç ; (iii) në datën 3.9.2015, djali i subjektit ka kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti, duke paguar detyrimin doganor, në total në shumën 54,171 lekë (vlera statistikore e këtij automjeti vlerësuar 270,860 lekë); (iv) në datën 16.9.2015, shtetasi B.Ç , si përfaqësues me prokurë i shtetasit I.K , ia ka shitur vetes këtë automjet për vlerën 3,000 euro; (v) në datën 12.4.2019, shtetasi B.Ç e shet²⁹ këtë automjet kundrejt çmimit 3,000 euro.

56. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë – me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen deri në datën 10.3.2015 të pagesës për blerjen e automjetit tip “***”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 16.9.2015	Vlerat në lek
A) Pasuri	601,211
Automjeti tip “***”, me targë AA ***	137,650
Automjet tip “***”, me targë AA ***	418,650
Ndryshim likuiditeti	44,911
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	601,211
D) Të ardhura	1,538,744
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	977,436
Të ardhura nga paga/pagesa e papunësisë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	144,570
Të ardhura nga paga, B.Ç	266,738
Të ardhura nga shitja e automjetit “***”, me targë AA ***	150,000
E) SHPENZIME	653,979
Shpenzime jetike	629,202
Shpenzime udhëtime jashtë vendit	24,777
Balanca e fondeve (D-C-E)	283,554

57. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe se kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e këtij automjeti.

58. **Pasuria e llojit likuiditete - gjendje cash**, disponuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur. Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar disponimin e likuiditeteve në gjendje *cash*, të evidentuara si më poshtë vijon:

²⁸ Shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 5.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.2.2021).

²⁹ Kontratë shitje prone – pasuri e luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.4.2019, redaktuar nga noteri publik, znj. A.B.

58.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit likuiditete - gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në shumën 500,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga pagat, kursime ndër vite, si dhe të ardhurat nga shitjet e automjeteve.

58.2 Personi i lidhur, djali i subjektit, E.Ç , ka deklaruar se disponon pasurinë e llojit likuiditete - gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në shumën 85,000 lekë.

58.3 Personi i lidhur, djali i subjektit, B.Ç , ka deklaruar se disponon pasurinë e llojit likuiditete - gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në shumën 200,000 lekë, me burim të ardhurat nga pagat dhe shitja e automjeteve.

59. Pra, rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar se disponojnë gjendjen e likuiditeteve *cash*, në total shumën prej 785,000 lekësh.

60. Konstatimi i ILDKPKI-së në lidhje me këto pasuri: (i) Subjekti ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar; (ii) Djali i subjektit, E.Ç , ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar; (iii) Djali i subjektit, B.Ç , ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar.

Deklarimet e bëra ndër vite mbi likuiditetet *cash* (shitesa/pakësime/gjendje)

61. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë bërë deklarime lidhur me disponimin e likuiditeteve në gjendje *cash*, sa vijon:

61.1 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 450,000 lekë (kursime të vitit 2015 me të ardhurat nga pagat dhe shitja e automjetit). Pjesa që zotëron 50%.

61.2 Në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin e deklaramit të të ardhurave, personi i lidhur B.Ç ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 150,000 lekë, me burim të ardhurat nga paga dhe shitja e automjeteve.

61.3 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 900,000 lekë (kursime ndër vite me të ardhura nga pagat dhe shitja e automjetit). Pjesa që zotëron 100%.

61.4 Në DIPP-në e vitit 2016, në deklarimin e bërë veçmas, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se disponon gjendje *cash* në shumën 50,000 lekë.

61.5 Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur B.Ç deklaroi si pasuri veçmas gjendje *cash* në shumën 150,000 lekë, me burim të ardhurat nga paga dhe shitja e automjeteve.

62. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur në ILDKPKI mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* ndër vite (duke ndjekur logjikën e deklaramit), duket se ecuria e gjendjes së kursimeve në formë likuiditetesh *cash* të disponuara prej tyre nga viti 2015 deri në fund të vitit 2016, paraqitet e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Analizë e ecurisë së shtesave/pakësimeve dhe gjendjes së likuiditeteve <i>cash</i> sipas deklarimeve periodike të subjektit dhe personave të lidhur (vlerat në lek)			
Viti	Shtesë	Pakësim	Gjendje
DIPP 2015	0	0	600,000
DIPP 2016	500,000	0	1,100,000
Deklaruar në Vetting më 26.1.2017			785,000

63. Sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi vetëdeklarimet e bëra ndër vite për likuiditetet *cash*, si dhe të deklarojë mbi destinacionin e shumës 315,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën mes vlerës 1,100,000 lekë, evidentuar si shuma e gjendjes *cash* në datën 31.12.2016 – bazuar në vetëdeklarimet e bëra ndër vite në ILDKPKI – dhe vlerës 785,000 lekë, të deklaruar si gjendje totale e likuiditeteve *cash* të disponuara prej subjektit dhe personave të lidhur në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

64. Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i ka qëndruar deklarimeve të bëra prej tij dhe personave të lidhur mbi disponimin e gjendjeve të likuiditeteve *cash*, duke parashtruar se pakësimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në janar të vitit 2017, në shumën 315,000 lekë, ka pasur si destinacion blerjen e disa pajisjeve elektronike.

65. Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e dhëna dhe nuk ka dyshime të tjera mbi deklaratën e bëra nga subjekti dhe personat e lidhur mbi disponimin e likuiditeteve në gjendje *cash* në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe shtesat dhe/apo pakësimet e tyre ndër vite.

Analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 dhe vitet 2004 – 2016³⁰

66. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratën e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe pasi u vlerësuan me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën 1992 – 2003 dhe vitet 2004 – 2016, nga ku rezultoi se periudha 1992 – 2003 paraqitet me balancë negative fondesh, në shumën -1,303,043 lekë.

67. Si konkluzion, referuar kësaj analize, rezultoi një balancë negative fondesh, në total në vlerën prej rreth 1.3 milionë lekësh, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1992 – 2003, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

³⁰ Referojuni tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, aneks nr. 1 – pjesë e këtij materiali (Rezultatet e Hetimit Administrativ).

Çështje të tjera të lidhura me kriterin e vlerësimit të pasurisë

68. Pasuria e llojit automjet tip “* ”**, me targë AA ***, vit prodhimi 2004, blerë nga shtetasi B.Ç në datën 14.3.2013, kundrejt çmimit 4,000 euro.

69. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “***”, me targë AA ***, me vlerë 4,000 euro, duke cilësuar si blerës djalin e tij B.Ç , por se nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

70. DPSHTRR-ja³¹ informon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA ***. Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja konfirmohet se në datën 1.9.2012 shtetasi Gj.Ç e ka blerë këtë automjet kundrejt çmimit 4,000 euro e, më pas, në datën 5.9.2012 ka kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti, duke paguar detyrimin doganor, në total në shumën 111,220 lekë. Në vijim, rezulton se në datën 14.3.2013 djali i subjektit të rivlerësimit e ka blerë³² këtë automjet për çmimin 4,000 euro. Komisioni konstatoi se në datën 18.9.2015 shtetasi B.Ç e ka shitur këtë automjet kundrejt çmimit 4,500 euro.

71. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë – me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen deri në datën 14.3.2013 të pagesës për blerjen e automjetit tip “***”, nga ku duket se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. U evidentua balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 330,000 lekësh. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

72. Referuar të dhënave të përfituara nga Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare (në vijim AMF) konstatohet se djali i subjektit, E.Ç , është shënuar si përdorues në policat e sigurimit të tipit “TPL” të këtij automjeti (***) me targë AA ***), edhe pas shitjes së tij nga shtetasi B.Ç shtetasit A.K , për periudhat si vijon: (i) 19.9.2016 – 18.9.2017; (ii) 18.9.2017 – 17.9.2018; (iii) 24.9.2018 – 23.9.2019; (iv) 1.10.2019 – 30.9.2020; (v) 1.10.2020 – 30.9.2021; (vi) 12.10.2021 – 11.10.2022. Ndërsa, vetë subjekti i rivlerësimit figuron i shënuar si përdorues në policat e sigurimit të tipit “TPL” të këtij automjeti, edhe pas shitjes së tij nga shtetasi B.Ç shtetasit A.K, për periudhat si vijon: (i) 19.9.2016 – 18.9.2017; (ii) 18.9.2017 – 17.9.2018. Madje, për këto periudha evidentohen policat e sigurimit të tipit “TPL”, ku nuk është shënuar emri i pronarit të këtij automjeti, shtetasi A.K .

73. Nga të dhënat e përfituara prej sistemit TIMS rezulton se ky automjet është përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij (bashkëshortja dhe djemtë) në datën 8.1.2017, për një udhëtim jashtë vendit. Gjithashtu, konstatohet se ky automjet është përdorur nga familjarët e subjektit (bashkëshortja dhe djemtë) për disa udhëtime të tjera jashtë vendit, përkatësisht në datat: (i) 2.1.2017; (ii) 29.6.2017; (iii) 1.8.2017; (iv) 28 - 29.4.2019; (v) 4.5.2019. Për më tepër, nga verifikimi i të dhënave prej sistemit TIMS për shtetasin A.K , duket se pas “blerjes” prej tij

³¹ Shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 5.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.2.2021).

³² Kontratë shitjeje e pasurisë së luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.3.2013, redaktuar nga noteri publik, z. P.Z.

të automjetit nga djali i subjektit, B.Ç , ai ka kryer hyrje-dalje të shpeshta jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me automjete të ndryshme, por se vetëm një hyrje-dalje e ka bërë me automjetin tip “****” me targë AA ***, në datën 2.1.2017, dhe se ky udhëtim është bërë së bashku me djalin e subjektit, E.Ç .

74. Nga sa u analizua më sipër, nga tërësia e rrethanave të evidentuara duket se në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (datë 26.1.2017), subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur me të e kanë pasur në përdorim automjetin në fjalë, pasi kanë pasur policë sigurimi të vlefshme në atë moment kohor, në të cilën shënohen si “përdorues”, si dhe evidentohen udhëtime të kryera prej tyre jashtë vendit, para dhe pas dorëzimit të kësaj deklaratë. Por, rezulton se subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur nuk kanë deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

75. Gjithashtu, në kushtet kur subjekti apo personat e lidhur nuk e kanë deklaruar këtë pasuri të luajtshme në përdorim në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe në konsideratë të faktit nga ku duket se kanë përdorur në mënyrë të vazhdueshme edhe pasi ka ndryshuar pronësia (pronari), Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të disponuar nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo djemtë e tij, të regjistruar në emër të shtetasit A.K.

76. Me dërgimin e rezultateve të hetimit në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi konstatimin e evidentuar si më sipër – mosdeklarimin e përdorimit të pasurisë objekt vlerësimi, si dhe mbi dyshimet e ngritura për disponimin e pasurisë së fshehur nga subjekti apo djemtë e tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

77. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e tij dhe depozitoi prova të reja shitesë mbi konstatimet e bëra nga Komisioni në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, duke parashtruar sa më poshtë vijon:

77.1 *Së pari*, subjekti deklaroi se një pjesë e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti në datën 14.3.2015 janë përballuar nga kursimet familjare, kurse pjesa tjetër është huazuar nga djali. Kështu, subjekti pretendon se djali i tij ka marrë një hua nga shtetasi P.P³³ (mik i familjes), në shumën 300,000 lekë, të cilën referon se e ka thyer brenda vitit 2013. Pra, ky detyrim nuk ekzistonte në datën 31.12.2013 dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar nga djali. Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti ka evidentuar faktin se në datën 28.10.2013 djali i tij B.Ç ka shitur kundrejt vlerës 300,000 lekë automjetin me targë AA ***, vlerë e cila është përfituar nga shitja e këtij automjeti dhe ka shërbyer për kthimin e huas shtetasit P.P , pasi nëse nuk do të ishin destinuar për shlyerjen e kësaj huaje, do të ishin deklaruar si gjendje *cash*.

³³ Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar si prova të reja: (i) deklaratën noteriale të shtetasit P.P, nr. **** rep., datë 28.10.2024; (ii) deklaratën noteriale të djalit të tij, B.Ç, nr. **** rep., datë 28.10.2024, të redaktuara nga noteri publik, z. A.K .

77.2 *Së dyti*, subjekti deklaroi se shtetasi A.K është mik i ngushtë i djalit të tij, E.Ç , dhe se në periudhën që e ka blerë këtë automjet nga djali tjetër, B.Ç , ka qenë futbollist profesionist dhe në lëvizje, pasi ka qenë i federuar në ekipe të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke referuar se këtë automjet e ka blerë për t'u shërbyer prindërve të tij, të cilët ishin me probleme shëndetësore. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se përdorimi i këtij automjeti prej djalit të tij nuk ka qenë i vazhdueshëm për të qenë objekt deklarimi dhe nëse i biri do ta dinte faktin se duhej ta deklaronte në deklaratën *Vetting* përdorimin e këtij automjeti, atëherë kjo do të ishte një rrethanë që do ta deklaronte pa asnjë hezitim. Sa i përket policave të sigurimit, përdorimi dhe emri i djalit në policën e sigurimit ka qenë për faktin se ai me shtetasin A.K janë miq të ngushtë dhe se ata rrinë gjithmonë bashkë, duke evidentuar se këto polica janë plotësuar nga agjentët dhe kanë vazhduar tek e njëjta agjenci, ku djali shkon gjithmonë me A për prerjen e siguracionit vjetor të këtij mjete.

77.2.1 Komisioni, ndër të tjera, konstaton se në mbështetje të deklarimeve të tij me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 29.10.2024, të shtetasit A.K (pronarit të automjetit), sipas së cilës ky i fundit ka deklaruar se është pronari i ligjshëm i automjetit tip “***”, me targë AA ***, të cilin e disponon që nga viti 2015, dhe se për shkak të rrethanave të njohjes dhe miqësisë me djemtë e subjektit të rivlerësimit, ia ka lënë herë pas here për ta përdorur djalit të subjektit, E.Ç , në ndonjë rast, si dhe për të dalë jashtë vendit. Gjithashtu, ky shtetas ka deklaruar se përdorimi ka qenë i shkurtër, një - dy ditë, kur nuk i është nevojitur automjeti, dhe në të gjitha rastet ka qenë në dijeni të përdorimit të automjetit dhe lëvizjeve të kryera prej tij. Në përfundim, ka deklaruar se, *nisur nga fakti se ka pasur njohje me agjentë të sigurimeve E , ka shkuar së bashku me E për të përfutur sadopak ulje në vlerën e siguracionit e, për këtë arsye, emrat E, B dhe Lazer Çardaku kanë mbetur në policën e sigurimit.*

77.3 Si përfundim, subjekti parashtron se nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur, pasi duke referuar rezultatet e analizës financiare të vitit 2015, e cila rezultoi me balancë pozitive fondesh në shumën 555,457 lekë (vit në të cilin subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 600,000 lekë), ai dhe familja e tij mund të deklarorin edhe tepricat si gjendje pasurie. Pra, sipas subjektit, nëse familja e tij do të kishte nevojë për likuiditete dhe do të rezultonte se ato ishin përdorur, atëherë do të merrte kuptim shitja fiktive e automjetit dhe disponimi *de facto* i kësaj pasurie, duke referuar se të ardhurat nga shitja e këtij automjeti nuk janë destinuar/përdorur për shtim pasurie.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm

78. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi konstatimet e bëra në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi – trupi gjykues argumenton sa më poshtë vijon:

78.1 Në shqyrtim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti mbi marrëdhënien e huas së pretenduar në vitin 2013 mes djalit të tij dhe shtetasit P.P , më konkretisht në vlerësim të qëndrimit të tij se kjo hua është shlyer brenda vitit dhe për këtë shkak nuk ka pasur detyrim ta deklaronte, trupi gjykues çmon se gjithsesi në rubrikën e deklarimit të pasurive të vitit 2013, ai/apo personi i lidhur ka pasur detyrimin ta pasqyrojë këtë hua si burim krijimi të automjetit tip “***” me targë AA ***, pra të referonte burimin konkret të blerjes së kësaj pasurie. Kështu, në formularin e deklarimit të pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë – pasuri të paluajshme

dhe të luajtshme”, që i përket deklaratës së interesave privatë të vitit 2013, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) të ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe burimin e krijimit të pasurisë (në këtë rast të blerjes së automjetit). Komisioni vëren se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2013, e cila sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se kjo marrëdhënie huaje, pavarësisht se pretendohet si e mbyllur brenda vitit, do të duhej të deklarohet/raportohej nga subjekti i rivlerësimit, kjo në kuptim të verifikimeve që mund të bëheshin nga ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

78.2 Në këtë kontekst, Komisioni arrin në përfundimin se edhe shuma prej 300,000 lekësh, e pretenduar si e marrë hua nga djali i subjektit, B.Ç , prej shtetasit P.P , në datën 14.3.2013, nuk do të reflektohet si e ardhur që mund të ketë shërbyer për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

79. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen deri në datën 14.3.2013 të pagesës për blerjen e automjetit tip “***”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2013 – 14.3.2013	Vlerat në lek
A) Pasuri	582,404
Automjeti tip “***”, me targë AA ***	559,360
Ndryshim likuiditeti	23,044
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	582,404
D) Të ardhura	349,012
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	290,982
Të ardhura nga paga/pagesa e papunësisë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	58,030
E) Shpenzime	98,910
Shpenzime jetike	98,910
Balanca e fondeve (D-C-E)	-332,302

80. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

81. Sa i përket konstatimit të bërë për mosdeklarimin e përdorimit të këtij automjeti dhe dyshimeve të ngritura për pasuri të fshehur të disponuar nga subjekti apo personat e lidhur me të, në vlerësim të deklaratës noteriale të shtetasit A.K , të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar përdorimin e automjetit nga djali i tij, E.Ç , Komisioni sjell në vëmendje qëndrimet që ka mbajtur Kolegji në jurisprudencën e tij në çështje të ngjashme, sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga rrethanat apo provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

82. Gjithsesi, në vlerësim të të gjitha rrethanave të evidentuara lidhur me këtë automjet në raport me shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti nëpërmjet prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni çmon se nuk u administruan indicie/prova të mjaftueshme, të tilla që të bënin të mundur qëndrimin e mbajtur/konstatimin fillestar, që i përket dyshimeve të ngritura për pasuri të fshehur të disponuar nga subjekti apo personat e lidhur me të.

83. Nga ana tjetër, lidhur me situatën faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të rezultuar gjatë hetimit, trupi gjykues i qëndron konstatimit fillestar, duke çmuar se në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 3, pika 11 dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti apo personat e lidhur kanë pasur detyrimin ta deklarojnë në deklaratën *Vetting* këtë pasuri në përdorim.

83.1 Kështu, referuar pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, *pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.* Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit “*Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij*”, detyronte subjektin e rivlerësimit apo personat e lidhur të deklarorin në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim, përderisa kanë pasur policë sigurimi të vlefshme në atë moment kohor, në të cilën shënohen si “përdorues”, si dhe evidentohen udhëtime të kryera prej tyre jashtë vendit para dhe pas dorëzimit të kësaj deklarate.

83.2 Referuar pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ndërsa, në pikën 1 të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se *subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.*

84. Për sa më sipër, Komisioni çmon se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* (datë 26.1.2017), provohet nga aktet e administruara se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur kanë pasur në përdorim automjetin në fjalë, situatë kjo që e çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur janë në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim. Në përfundim të analizës, rezulton se në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit në fjalë subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

85. Pasuria e llojit automjet tip “*”, me targë AA ***, vit prodhimi 1999, blerë nga shtetasi B.Ç në datën 10.3.2015, kundrejt çmimit 1,000 euro.**

86. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar blerjen e kryer nga personi i lidhur, djali B.Ç , të automjetit tip “***”, me targë AA ***, me vlerë 1,000 euro, por se nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

87. DPSHTRR-ja³⁴ informon se djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë AA ***. Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja, rezulton se: (i) në datën 7.4.2014, shtetasi A.Sh e ka blerë këtë automjet për çmimin 100 euro; (ii) në datën 7.10.2014 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti, duke u paguar detyrimi doganor në shumën 7,133 lekë; (iii) në datën 10.3.2015, djali i subjektit, B.Ç , e ka blerë³⁵ këtë automjet për çmimin 1,000 euro; (iv) në datën 1.7.2015, djali i subjektit, B.Ç , e ka shitur³⁶ këtë automjet kundrejt çmimit 150,000 lekë.

88. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë – me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen deri në datën 10.3.2013 të pagesës për blerjen e automjetit tip “***”, nga ku duket se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. U evidentua balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 65,000 lekësh. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

89. Me dërgimin e prapësimeve në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni mbi këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar se megjithëse nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2014, gjithsesi ai ka pasur në gjendje kursime të cilat, së bashku me të ardhurat e realizuara për periudhën janar – mars të vitit 2015, kanë mundësuar blerjen në datën 10.3.2015 (nga djali tij, B.Ç), të automjetit tip “***”, me targë AA ***, me vlerë 1,000 euro.

³⁴ Shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 5.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.2.2021).

³⁵ Kontratë shitjeje e pasurisë së luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. Sh.Gj.

³⁶ Kontratë shitblerjeje pasurie të luajtshme të automjetit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2015, redaktuar nga noteri publik, z. K.R.

90. Sa i përket pretendimit të subjektit për mbartjen e të ardhurave në formë kursimesh ndër vite, Komisioni sjell në vëmendje se në përputhje me shkronjën “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunëve publikë”, i ndryshuar, subjektet deklarues kanë pasur detyrimin të deklarojnë në deklaratat e interesave privatë vlerën e likuiditeteve gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Në kushtet kur rezulton se në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë paraardhëse, deri në DIPP-në e vitit 2014, subjekti dhe/apo personat lidhur nuk kanë deklaruar shtesa/gjendje likuiditetesh *cash*, ky pretendim i subjektit gjendet i papabazuar.

91. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë – me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen deri në datën 10.3.2013 të pagesës për blerjen e automjetit tip “****”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 5

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 10.3.2015	Vlerat në lek
A) Pasuri	235,635
Automjeti i markës “****”, me targë AA ***	137,650
Ndryshim likuiditeti	97,985
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	235,635
D) Të ardhura	343,569
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	325,783
Të ardhura nga paga, B.Ç	17,786
E) Shpenzime	172,047
Shpenzime jetike	172,047
Balanca e fondeve (D-C-E)	- 64,113

92. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

93. Apartamenti i ndodhur në O, Shkodër, blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 1994 për shumën 200,000 lekë, shitur në vitin 2005 për shumën 200,000 lekë.

94. Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi 1+1, ndodhur në fshatin O, me sipërfaqe 48.5 m², për të cilin referon se e ka fituar me privatizim dhe e ka shitur në vitin 2005 për shumën 200,000 lekë.

95. Komisioni konstaton se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie (deklaratë e vitit 2003, depozituar në ILDKPKI në datën 19.3.2004) dhe se po ashtu nuk është deklaruar shitja e saj (pakësimi) në vitin 2005 (në DIPP-në e vitit 2005).

96. Gjithashtu, referuar dokumentacionit tekniko-ligjor të kësaj pasurie, rezulton se ajo është përfituar nga subjekti nëpërmjet kontratës së shitblerjes datë 8.12.1994, me palë shitëse shtetasit Gj.B dhe S.B.

97. Pasi Komisioni kërkoi³⁷ të shpjegojë mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie (deklarata e vitit 2003, depozituar në ILDKPKI në datën 19.3.2004), si dhe për mosdeklarimin e pakësimit të saj (shitjes) në deklaratën e interesave private të vitit 2005 dhe mbi deklarimin e bërë se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet privatizimit, ndërkohë që duket se ajo është përfituar nëpërmjet blerjes, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se këtë pasuri *de facto* e ka shitur në datën 20.8.1999 dhe, për këtë arsye, ajo nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2003 dhe atë të vitit 2005, kur është formalizuar shitja. Ndërsa, sa i përket deklarimit të bërë mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, subjekti ka sqaruar se kur ka parashtruar një deklarim të tillë ka pasur parasysh faktin se banesa në fjalë e kishte prejardhjen nga Enti Kombëtar i Banesave dhe jo se ky përfitim i kësaj pasurie vjen drejtpërdrejt për vetë atë. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se çmimi i dakordësuar për blerjen e kësaj pasurie prej tij (shuma 200,000 lekë) është paguar i shtrirë në kohë përgjatë viteve 1994 – 1997, pavarësisht se në kontratën e shitblerjes ka qenë e përcaktuar se likuidimi i kësaj shume është bërë menjëherë.

98. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i ka qëndruar të gjitha shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ në lidhje me gjetjet/konstatimet e bëra nga Komisioni mbi këtë pasuri dhe rezultatin e analizës financiare për evidentimin e mundësisë së subjektit për blerjen e saj.

99. Në shqyrtim përfundimtar të deklarimeve të bëra dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve në raport me dokumentacionin shkresor të administruar në dosje, Komisioni vëren se ato janë kryesisht të karakterit deklarativ dhe, në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se mbeten pasaktësitë e konstatuara në mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e vitit 2003 dhe të pakësimit të saj në atë të vitit 2005, pavarësisht se këto pasaktësi vlerësohen se kanë një peshë specifike të vogël për efekt të këtij procesi, për sa kohë me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e shitjes së kësaj pasurie. Në këtë kontekst, në analizën financiare përfundimtare u vlerësua se pagesa për blerjen e kësaj pasurie në shumën 200,000 lekë është kryer nga subjekti në datën 8.12.1994 dhe se të ardhurat e përfituara nga shitja e saj do të reflektohen në vitin 2005.

100. Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë – me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen deri në datën 8.12.1994 të pagesës për blerjen e apartamentit të banimit në O, Shkodër, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

³⁷ Pyetësi nr. ***, i dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

Tabela nr. 6

Analiza financiare për periudhën 1992 – 8.12.1994	Vlerat në lek
A) Pasuri	200 000
Apartament banimi 1+1, ndodhur në O, Shkodër	200 000
Ndryshim likuiditeti	0
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	200 000
D) Të ardhura	212 928
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	196 928
Të ardhura nga paga/pagesa e papunësisë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	16 000
E) Shpenzime	140 532
Shpenzime jetike	140 532
Balanca e fondeve (D-C-E)	-127 604

100.1 Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

101. Automjeti tip “**”, me targë AB *****, ku subjekti i rivlerësimit figuron i shënuar si “përdorues” në polica sigurimi.

102. Pas verifikimit të kryer në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare, duket se subjekti i rivlerësimit është shënuar si “përdorues” në policat e sigurimit të automjetit tip “****” me targë AB ***, vit prodhimi 2018, me pronar të identifikuar shtetasin K. T, polica të cilat i përkasin periudhave 24.4.2023 – 23.4.2024 dhe 23.4.2024 – 22.4.2025.

103. Nga të dhënat e përfituara nga sistemi TIMS, rezulton se ky automjet është përdorur në datën 29.4.2023 nga subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij, B.Ç , për një udhëtim jashtë vendit. Për më tepër, nga verifikimi i të dhënave prej sistemit TIMS për shtetasin K.T, duket se ai ka kryer hyrje-dalje të shpeshta jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me automjete të ndryshme, por asnjëherë me automjetin tip “****” me targë AB ***.

104. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja³⁸ për këtë automjet në raport me të dhënat e përfituara nga AMF-ja, duket se menjëherë pas blerjes së këtij automjeti nga shtetasi K.T , në momentin që është prerë polica e re e sigurimit, si dhe në policën pasardhëse, emri i subjektit të rivlerësimit është shënuar si “përdorues” i këtij automjeti.

105. Në këto rrethana, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme për pasuri të fshehur të subjektit, të disponuar prej tij dhe/apo djalit të tij, B.Ç , të regjistruar në emër të shtetasit K.T . Për rrjedhojë, me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi dyshimet e ngritura. Gjithashtu, i ka kërkuar të japë detaje mbi përdorimin e kësaj pasurie dhe lidhjen/marrëdhënien e tij me pronarin e këtij automjeti.

³⁸ Shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 12.8.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.8.2024).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

106. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka parashtruar se ka pasur si qëllim blerjen e këtij automjeti dhe e ka marrë në përdorim prej mesit të muajit mars 2023. Por, pas dakordësisë për çmimin dhe kryerjen e dorëzimit të automjetit, për shkak se shtetasi K.T nuk është paraqitur për ta finalizuar këtë marrëdhënie, e më tej është larguar nga Shqipëria në fund të muajit korrik 2023, nuk ka mundur ta nënshkruajë kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie. Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar se nuk e ka njohur më parë shtetasin K.T dhe se kontakti i parë me të ka qenë në momentin që janë takuar për të diskutuar blerjen e këtij automjeti. Në vijim, subjekti deklaroi se prej muajit korrik të vitit 2023 e deri në 30 prill të vitit 2024, shtetasi K.T ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, rrethanë për të cilën referon se ka pamundësuar nënshkrimin e kontratës gjatë kësaj periudhe. Në përfundim të shpjegimeve të tij, parashtron se me ardhjen e këtij shtetasi në Shqipëri në datën 2.5.2024, bashkë me të janë paraqitur pranë sporteleve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor për të realizuar kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, por se aty është vënë në dijeni se pas verifikimeve të bëra mjeti rezultoi me “Interpol Pozitiv”. Në këto rrethana, deklaroi se ia ka dorëzuar automjetin shtetasit K.T, duke mos e finalizuar këtë marrëdhënie dhe duke e orientuar këtë shtetas ta dorëzojë automjetin pranë Drejtorisë së Policisë Shkodër.

107. Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë të re shkresën e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër me nr. *** prot., datë 23.10.2024, sipas së cilës, ndër të tjera, referohet se, për sa i përket automjetit tip “****” me targë AB ***, pas verifikimeve në dosjen bazë të këtij mjeti rezultoi se në datën 2.5.2024 janë paraqitur në sportelet e kësaj Drejtorie për të realizuar kontratën e shitblerjes së mjetit shtetasit K.T (në cilësinë e shitësit) dhe Lazer Çardaku (në cilësinë e blerësit), por se pas verifikimeve në sistem ky mjet rezultoi me “Interpol Pozitiv”, duke sjellë si rrjedhojë ndërprerjen e procedurës për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj kontrate.

108. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nuk pasur detyrimin për deklarimin e përdorimit të këtij automjeti në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2023.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

109. Pasi vlerësoi provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet dhe provat e depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, në kushtet kur edhe vetë subjekti pranoi përdorimin e këtij automjeti dhe se ka pasur qëllim blerjen e tij, Komisioni përfundimisht vlerëson se nuk mund të qëndrojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm konstatimi për pasuri të fshehur të subjektit.

110. Gjithsesi, trupi gjykues çmon se subjekti dështoi të shpjegojë bindshëm mbi faktin se pse nuk e ka finalizuar në kohë transaksionin me shtetasin K.T. Kështu, nga verifikimi i të dhënave të sistemit TIMS, duket se konfirmohet se ky shtetas për periudhën korrik 2023 – prill 2024 ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Por, megjithatë, nuk mund të justifikohet mbajtja e këtij automjeti në përdorim nga subjekti pa asnjë tagër dhe pa kundërshtim për një periudhë të gjatë kohore, për më shumë se një vit (mars 2023 – prill 2024), kjo vlerësuar edhe me rrethanën e deklaruar nga vetë subjekti se nuk kishte njohje me shtetasin K.T. Për më tepër, duket se kjo situatë e ka çuar subjektin në përdorimin e një automjeti, i cili ka rezultuar me statusin “Interpol Pozitiv”. Të gjitha këto rrethana të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën

cenojnë figurën e prokurorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të bërë në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

111. Gjithashtu, megjithëse kemi të bëjmë me pasuri të përdorur pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në analizë të të gjitha prapësimeve të bëra nga subjekti mbi këtë pasuri – Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i tij se nuk ka pasur detyrim deklarim në përdorimit të këtij automjeti në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2023. Kështu, Komisioni sjell në vëmendje se me ligjin nr. 42/2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, në shkronjën “b” të nenit 4 të ligjit ekzistues, që referon deklarimin e pasurive të luajtshme, pas fjalëve “në regjistrat publikë”, shtohen fjalët “dhe të drejtat reale mbi to”, sipas Kodit Civil.

112. Mbi dyshimet e hedhura në disa denoncime për pasuri të paluajtshme – apartament të fshehur të subjektit të rivlerësimit, të ndodhur në zonën e plazhit të V

113. Pranë Komisionit janë administruar tri denoncime, në dukje anonime³⁹, të cilat hedhin dyshime për fshehje pasurie nga ana e subjekti i rivlerësimit, prokurorit Lazer Çardaku. Kështu, në këto denoncime referohet se prokurori Çardaku disponon një apartament në zonën e plazhit, në V, në objektin e ndërtuar nga ish-kryetari i komunës, i ndjeri P.U. Dy prej denoncimeve shoqërohen me lista të pretenduara të banorëve të këtij objekti/pallati për pagesat e shërbimeve utilitare, ku duket se është shënuar edhe emri i subjektit të rivlerësimit, Lazer Çardaku. Gjithashtu, në njërin prej denoncimeve jepen të dhëna konkrete mbi objektin/pallatin si, shoqëria ndërtuese, numri i pasurisë, zona kadastrale⁴⁰ etj., si dhe foto nga *Google Earth*.

114. I pyetur më parë nga Komisioni⁴¹ nëse gjatë gjithë periudhës së deklarimit ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emër të dikujt tjetër si (automjete, shtëpi, mjete lundrimi, apartamente, shtëpi verore etj.), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁴² nuk ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emër të dikujt tjetër.

115. Komisioni kërkoi⁴³ nga ASHK Drejtoria Vendore Shkodër informacion të plotë mbi të gjitha pasuritë e regjistruara (apartamente, garazhe, njësi) dhe pronarët përkatës lidhur me objektin e ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse “****” sh.p.k., i cili ndodhet në zonën e V, regjistruar me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, volum ***, faqe ***.

115.1 ASHK Drejtoria Vendore Shkodër⁴⁴ informon se pasuria nr. ***, volum ***, faqja ***, zona kadastrale *** (P, Plazh), e llojit truall + ndërtesë me sipërfaqe 1,601.8 m², nga të cilat 1,083 m² ndërtesë, në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, është fituar me leje legalizimi nr. ***, datë 23.7.2014.

³⁹ (i) Denoncim anonim nr. *** prot., datë 6.9.2013; (ii) denoncim anonim nr. *** prot., datë 17.11.2023; (iii) denoncim i depozituar pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) nr. *** prot., datë 4.6.2024.

³⁹ Referuar nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁰ Duket se denoncuesi ka depozituar edhe një fletë të printuar nga sistemi i ASHK-së.

⁴¹ Pyetësori nr. ***, i dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

⁴² Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 3.2.2021.

⁴³ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 1.8.2024.

⁴⁴ Shkresa e ASHK Drejtoria Vendore Shkodër nr. *** prot., datë 16.9.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.9.2024).

116. Gjithashtu, në funksion të verifikimeve të kryera lidhur me këto denoncime, për objektin e sipërcituar – Komisioni kërkoi⁴⁵ nga shoqëria ndërtuese (“****” sh.p.k.) të dërgojë informacion të plotë mbi të gjitha pasuritë e regjistruara (apartamente, garazhe, njësi) dhe pronarët përkatës, duke evidentuar edhe pasuritë për të cilat nuk është kryer ende regjistrimi në hipotekë nga blerësit dhe për të referuar e për të depozituar kontratat e porositjes/sipërmarrjes dhe blerësit përkatës. Gjithashtu, iu kërkua të dërgojë të dhëna mbi administratorin e kësaj godine (gjeneralitetet e plota) dhe një numër kontakti të tij, si dhe që paraprakisht të depozitohet lista e banorëve të këtij objekti.

116.1 Shoqëria “**** ” sh.p.k. informon se⁴⁶ ka ndërtuar një objekt në V, P, Plazh, në zonën kadastrale ***, i cili ka një kat bodrum, një kat shërbime dhe pesë kate banimi. Në vijim, në shkresën e kësaj shoqërie referohet se duke qenë se objekti është ndërtuar i gjithi pa leje, është legalizuar dhe më pas ka shitur bodrumin, i cili shërben si parkim, njësitë e shërbimeve, si dhe apartamentet e banimit, duke konfirmuar se i gjithë pallati/objekti është shitur me dokumente të rregullta. Për këtë ka paraqitur listën e blerësve të këtyre pasurive dhe referencat përkatëse të kontratave të shitblerjes. Gjithashtu, shoqëria “**** ” sh.p.k. sqaron se nuk ka administrator të caktuar dhe se shërbimet e mirëmbajtjes i kryejnë vetë banorët.

116.2 Nga krahasimi i bërë mes listës së banorëve të këtij objekti të paraqitur me denoncimet e depozituara – ku hidhen dyshime se bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, prokurori Lazer Çardaku – me listën e blerësve faktikë të depozituar nga shoqëria “**** ” sh.p.k., duket se ka përputhje në masë të konsiderueshme mes tyre. Pra, duket se një pjesë e madhe e emrave të pasqyruara në listën e depozituar nga denoncuesit shfaqen si palë blerëse me shoqërinë “*****” sh.p.k. Në këtë kontekst, duket indicie e besueshme lista e paraqitur nga denoncuesit – për sa kohë gjen një përputhshmëri të lartë me personat që kanë nënshkruar kontrata shitblerjeje me shoqërinë “**** ” sh.p.k. Gjithashtu, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e pasurive të këtij objekti zotërohen nga familjarët të ndjerit, P.U , person i cituar në denoncime si ndërtues i këtij objekti.

116.3 Nisur nga të dhënat dhe indiciet e përfituara, Komisioni njoftoi shtetasin N.Ç (përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm i shoqërisë “**** ” sh.p.k.)⁴⁷ për t’u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit – me qëllim marrjen e dëshmisë së tij mbi rrethana që lidhen me këtë objekt dhe blerësit/apo përdoruesit e pasurive. Në datën 8.10.2024, ky shtetas u paraqit dhe dha dëshminë e tij para Komisionit, nga ku, ndër të tjera, ka deklaruar se e njeh prokurorin Lazer Çardaku, duke konfirmuar se ai ka qëndruar në atë godinë (objektin e ndërtuar nga shoqëria “**** ” sh.p.k., në V), të paktën atë vit që ka qëndruar edhe ai vetë aty (referon vitin 2017), por se nuk di të thotë se ku ka qëndruar – te cili apartament dhe nëse e ka pasur në përdorim apo e ka marrë me qira. Gjithashtu, në deklaratimet e tij duket se konfirmohet lidhja e të ndjerit P.U dhe familjarëve të tij me këtë godinë.

117. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi⁴⁸ Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër verifikimin në vend të këtij objekti dhe dërgimin e informacionit të plotë mbi të gjitha pasuritë e regjistruara (apartamente, garazhe, njësi) dhe pronarët përkatës, duke evidentuar edhe pasuritë për të cilat nuk është kryer ende regjistrimi në hipotekë nga blerësit dhe referuar kontratat e

⁴⁵ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 1.8.2024.

⁴⁶ Shkresa e shoqërisë “*****” sh.p.k., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.10.2024.

⁴⁷ Shkresa e Komisionit “Njoftim për paraqitje” me nr. *** prot., datë 27.9.2024.

⁴⁸ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 18.9.2024.

porositjes/sipërmarrjes dhe blerësit përkatës. Gjithashtu, Komisioni kërkoi të merren të dhëna mbi administratorin e kësaj godine (gjeneralitetet e plota) dhe një numër kontakti të tij, si dhe paraprakisht të administrohet e dërgohet lista e banorëve të këtij objekti.

117.1 Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër⁴⁹, në lidhje me informacionin e kërkuar mbi objektin e ndërtuar nga shoqëria “**** ” sh.p.k., me nr. pasurie ***, informon se kanë marrë kontakt dhe kanë intervistuar shtetasin A.C , kunatin e të ndjerit P.U, i cili merret me mirëmbajtjen dhe ruajtjen e godinës pas mbylljes së sezonit turistik. Nga informacioni i marrë prej këtij shtetasi, referohet se në këtë objekt janë 120 hyrje, nga të cilat 40 i administron familja U.

117.2 Gjithashtu, rezulton se strukturat e policisë kanë administruar nga OSSH-ja listën e abonentëve të regjistruar në kabinën “**** ” sh.p.k., nga ku nuk duket të shfaqet emri i subjektit apo personave të lidhur me të.

118. Nisur nga informacioni i dërguar nga Policia e Shtetit, Komisioni njoftoi shtetasin A.C për t’u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit, me qëllim marrjen e dëshmisë së tij mbi rrethana që lidhen me këtë objekt dhe blerësit/apo përdoruesit e pasurive. Në datën 14.10.2024, ky shtetas u paraqit dhe dha dëshminë e tij, nga ku, ndër të tjera – mbi pyetjet e drejtuara nga Komisioni ka deklaruar se merret me mirëmbajtjen e objektit të ndërtuar nga kunati i tij, i ndjeri P.U , por se administratore është motra e tij, N.U . Gjithashtu, ai ka deklaruar se kunati i tij, i ndjeri P.U, ka pasur lidhje miqësie me prokurorin Lazer Çardaku. Sa i përket subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, referon se ka ardhur te objekti dhe ka qëndruar për pushime – ndoshta në hotel. Gjithashtu, deklaroi se: *“Lazer Çardaku vjen në hotel se ka shok B.G dhe kanë ndejtur edhe te restoranti”*. Sa i përket shtetasit B.G , nga dëshmia del se është i njëjti person i identifikuar me emrin M.L , i cili rezulton se së bashku me dy djemtë e tij kanë blerë tri apartamente te godina objekt verifikimi. Gjatë dëshmisë së tij, shtetasi A.C pohoi se i njeh pjesën më të madhe të banorëve të këtij objekti, por pasi u ballafaqua me listën e banorëve të bashkëngjitur në denoncimet e depozituara pranë Komisionit, hedh dyshime mbi vërtetësinë e plotë të saj, duke deklaruar se, në dijeninë e tij, Lazer Çardaku nuk ka apartament në pronësi në këtë objekt.

119. Në vijim të krahasimit të listave të banorëve me blerësit faktikë, Komisioni vëren se megjithëse shtetasi M.L dhe djemtë e tij kanë blerë apartamente te kjo godinë, ata nuk rezultojnë të jenë të shënuar si banorë të objektit në listat e depozituara bashkëlidhur denoncimeve. I pyetur nga Komisioni mbi këtë rrethanë, shtetasi A.C deklaroi se ky shtetas i ka shitur 2 apartamente.

119.1 Nga informacionet e përfituara prej burimeve të hapura, por edhe burimeve ligjore, duket se shtetasi M.L ka qenë i implikuar në tjetërsimin e paligjshëm të trojeve në zonën e bregdetit të V. Kështu, nga verifikimi në tërësi i dy dosjeve penale të administruara nga Komisioni⁵⁰, duket se shtetasi M.L është përdorur nga persona të tretë për tjetërsimin e pronave. Pra, duket se ky shtetas është përdorur më parë për të regjistruar në emër të tij pasuri, të cilat *de facto* zotëroheshin nga të tjerët – e të dyshuara si të përfituara në kundërshtim me ligjin.

⁴⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 8.10.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.10.2024).

⁵⁰ Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me nr. *** prot., datë 15.10.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.10.2024).

119.2 Gjithashtu, nga të dhënat e përfituara nga sistemi TIMS konstatohet se në dhjetor të vitit 2018 subjekti i rivlerësimit ka kryer një udhëtim jashtë vendit me shtetasin M. L. dhe bashkëshorten e tij E. L.

120. Në vlerësim paraprak të të gjitha rrethanave dhe të dhënave të mësipërme, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka përdorur dhe/apo ka pasur në disponim një pasuri të paluajtshme në objektin e ndërtuar nga shoqëria “ *** ” sh.p.k. dhe me bashkëpronar familjen U, pasuri mbi të cilën ka shmangur deklaratimet në ILDKPKI dhe pranë Komisionit mbi përdorimin dhe/apo pronësinë *de facto* të saj. Në këtë kuptim, me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këto dyshime, duke i kërkuar gjithashtu të deklarojë e të japë detaje mbi marrëdhënien e tij me shtetasin M.L .

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

121. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti kundërshtimet e tij mbi dyshimet e ngritura nga Komisioni në lidhje me disponimin e pasurisë së paluajtshme të fshehur, duke mohuar ekzistencën e kësaj rrethane. Kështu, subjekti ka parashtruar se të paktën dy nga denoncimet janë dërguar nga i njëjti person, për të cilin referon se ka pasur akses të plotë të sistemi i ASHK-së, e në këtë kuptim ka pasur mundësi të verifikojë edhe emrat e pronarëve të objektit në fjalë, duke e lidhur këtë fakt me mundësinë e krijimit prej tij të një liste banorësh realë të këtij pallati, së bashku me emrin e tij, rrethanë kjo e evidentuar edhe nisur nga deklaratimet e dhëna nga shtetasi A.C, i cili ka hedhur dyshime mbi vërtetësinë e kësaj liste. Në vijim, subjekti ka pranuar faktin se ka qëndruar si pushues në këtë objekt për periudhën verore që i përket viteve 2017, 2018 dhe 2019, duke përdorur apartament, dhomë me qira/apo te hoteli në pronësi të shtetasit P.U, për të cilin thotë se ka pasur njohje personale. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se e njeh shtetasin M.L dhe familjen e tij prej shumë vitesh – pasi edhe fëmijët e tyre janë miq me njëri-tjetrin, por duke mohuar përdorimin e ndonjë pasurie të paluajtshme në pronësi të këtij shtetasi (në dukje edhe të familjarëve të tij).

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

122. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi dyshimet e ngritura nga Komisioni për pasuri të paluajtshme të fshehur në raport me provat e administruara gjatë hetimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm disponimi prej subjektit i kësaj pasurie në zonën e V.

123. Por, nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se subjekti nuk e ka mohuar përdorimin e një apartamenti apo dhomave të hotelit në godinën objekt hetimi, pasuri për të cilat ka referuar se në kohën e përdorimit prej tij kanë qenë në pronësi të shtetasit P. U , por se në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore krijohet përshtypja se e ka përdorur këtë/këto pasuri pa kundërshtim. Ndërkohë, sikurse u evidentua edhe më sipër, gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁵¹ nuk ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emër të dikujt tjetër.

⁵¹ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.2.2021.

124. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të hetimit – duke mos deklaruar përdorimin e kësaj pasurie – dhe se kjo sjellje e tij do të mbahet parasysh në vendimmarrje.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë

125. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer deklarim të rremë të pasurisë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

126. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës⁵².

127. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar (AKSIK, ish-DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

127.1 Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁵³ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

127.2 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku.*

128. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁵⁴ për përditësimin e raportit për vlerësimin e figurës me informacione shtesë të mundshme, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin e ri⁵⁵ mbi

⁵² Referuar nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

⁵³ Raporti i AKSIK (ish-DSIK) nr. *** prot., datë 2.11.2017.

⁵⁴ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 10.2.2023.

⁵⁵ Raporti i AKSIK (ish-DSIK) nr. *** prot., datë 26.6.2023, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. *** , datë 4.7.2023.

kontrollin e figurës, në përmbajtje të të cilit referohet se për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, *disponohen të dhëna... mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme...* Në këtë kontekst, në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, Grupi i Punës i AKSIK-së gjykon që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera, që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që janë kryer/po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

129. Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përftuara nga institucionet e verifikimit, Komisioni administroi dosjet/fashikujt e plotë të disa çështjeve penale⁵⁶, të hetuara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

130. Pas shqyrtimit dhe analizimit të këtyre dosjeve penale dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo dokumentacion për gjetje, mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Lazer Çardaku, për aspekte që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës.

131. Komisioni ka kryer edhe verifikime të tjera në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

132. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

133. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

134. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve⁵⁷.

135. Subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, rezulton se për periudhën rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁵⁶ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 24.7.2024 dhe shkresa kthim përgjigjeje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me nr. *** prot., datë 31.7.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 31.7.2024).

⁵⁷ Referuar nenit 40 të ligjit nr. 84/2016.

Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale⁵⁸

136. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së, si organi ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor – me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore – ka përpiluar një raport me qëllim analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Lazer Çardaku.

136.1 Referuar këtij raporti, subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin e ligjit dhe shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Evidentohet se ai ka respektuar të drejtat e palëve në proces, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, nuk konstatohen indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

137. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, nga ku, pas shqyrtimit të tyre, nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional.

138. Në vlerësimin e prokurorit Lazer Çardaku, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 6 denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe analizimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit – Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej tij në hetimin dhe trajtimin/shqyrtimin e çështjeve penale, që lidhen me 3 denoncime të depozituara nga publiku, si më poshtë vijon:

Denoncimi i shtetasit S.Sh⁵⁹

139. Denoncuesi ankohet kundër vendimit të subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2018. Nga verifikimi i ankesës së bërë nga denoncuesi në lidhje me këtë vendim, duket se ka ngritur pretendimin se vendimi është haptazi i padrejtë dhe i pabazuar në ligj e në fakte. Gjithashtu, ai pretendon se prokurori i çështjes, në kundërshtim me parimet dhe dispozitat procedurale penale, nuk ka kryer hetim të plotë, objektiv dhe të gjithanshëm të çështjes. Përkundrazi, sipas denoncuesit, siç del nga vendimmarrja e vendimit të pushimit, ai ka kryer veprime të njëanshme, duke arritur në konkluzionin e gabuar sikur “Fakti nuk parashikohet në ligj si vepër penale”, por si konflikt civil apo administrativ.

140. Për sa më sipër, denoncuesi në vijim pretendon se: (i) Së pari, në shkelje të praktikës më elementare të një procesi të rregullt penal, ai si person i dëmtuar nga vepra penale nuk është thirrur për të dhënë shpjegime dhe ballafaquar me personin që e kërcënon haptazi për jetën; (ii) Së dyti, nga përmbajtja e vendimit të pushimit të çështjes, del se i kallëzuarit prej tij ka paraqitur një certifikatë për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZVRPP Shkodër, me nr. ***, datë 5.11.2014, nga ku rezulton se në zonën kadastrale ***, nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, me adresë

⁵⁸ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 7.6.2023.

⁵⁹ Ankesa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

Shkodër – A , lloji i pasurisë pyll me sipërfaqe 4,100 m², është regjistruar në emër të bashkëshortes së tij, A.E ..., duke referuar se jo zyrtarisht është vënë në dijeni se kjo pronë është regjistruar bazuar në një vendim gjyqësor e duke ngritur pikëpyetje mbi ligjshmërinë e këtij vendimi për fitimin e pronësisë mbi pasuri ekskluzive publike, siç janë basenet ujore; (iii) Së treti, prokurori është bazuar në nenin 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale për pushimin e çështjes, por është në shkelje të pikës 2 të kësaj dispozite, ku thuhet se: *“Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton... personin që ka bërë kallëzimin apo ankim, duke i bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”*. Edhe këtë të drejtë referon se ia ka mohuar si subjekt i këtij procesi, duke mos e njoftuar.

141. Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër⁶⁰ dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2018, që lidhet me çështjen objekt denoncimi. Nga verifikimi i fashikullit të kësaj dosjeje penale rezulton se bazuar në kallëzimin e bërë në datën 17.10.2018 nga denoncuesi S.Sh, prokurori Çardaku ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2018, për veprën penale “Kanosja”, të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore të deleguara oficerit të policisë gjyqësore K. M., bazuar edhe në relacionin e punuar nga ky oficer për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***/***, prokurori Çardaku ka vendosur në datën 28.12.2018 pushimin e çështjes.

141.1 Rezulton se njoftimi i palëve në lidhje me përfundimin e hetimit dhe pushimin e çështjes është bërë me shkresën datë 19.1.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pra më shumë se 20 ditë pas marrjes së vendimit për pushimin e procedimit penal.

142. Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të japë shpjegimet e tij mbi pretendimet e ngritura në këtë denoncim, si dhe mbi konstatimin e bërë se viktima e veprës penale nuk është njohur brenda 5 ditëve me vendimin e pushimit të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e nenit 328/2 të Kodit të Procedurës Penale.

143. Me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka sqaruar se referuar akteve rezulton se dosja – së bashku me vendimin e pushimit – në të njëjtën ditë me vendimmarrjen është dorëzuar prej tij në sekretarinë e prokurorisë bashkë me shkresën përcjellëse për njoftimin e palëve për përfundimin e hetimit dhe pushimin e çështjes, e në vijim kjo shkresë është nënshkruar nga drejtuesi i Prokurorisë. Gjithashtu, subjekti referon se denoncuesi (viktima e veprës penale) është njohur me vendimin e pushimit dhe aktet e procedimit penal nr. ***/*** dhe se brenda afatit ligjor ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

143.1 Në vijim, subjekti ka parashtruar se, referuar vendimit nr. ***, datë 13.2.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka shqyrtuar në dhomë këshillimi ankimin e denoncuesit S.Sh kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e procedimit penal nr. ***/*** dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e ankimit, pra lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë. Në vijim, referon se ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi, shtetasi S.Sh, në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 28.3.2019, ka vendosur

⁶⁰ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 2.8.2024 dhe shkresa kthim përgjigjeje e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me nr. *** prot., datë 9.9.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.9.2024).

lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pra, si përfundim, subjekti i rivlerësimit parashtron se si Gjykata e Shkallës së Parë, edhe ajo e Apelit, kanë rrëzuar të gjitha pretendimet e ankuesit/kallëzuesit S.Sh, duke vlerësuar se vendimi i pushimit i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se nuk ka cenuar asnjë dispozitë procedurale që lidhet me përfundimin e hetimit, njohjen me vendimin e pushimit dhe të drejtën e ankimit⁶¹.

144. Në shqyrtim objektiv të prapësimeve të bëra, në raport me aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe ato të depozituara nga subjekti në lidhje me çështjen objekt denoncimi pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se pjesë e akteve të dosjes së procedimit penal nr. ***/*** është edhe shkresa nr. *** prot., datë 19.1.2019, për njoftimin e përfundimit të hetimeve dhe pushimin e çështjes penale nr. ***/***, drejtuar subjekteve të këtij procedimi penal, përfshirë edhe viktimën e veprës penale, shtetasin S.Sh, të firmosur nga drejtuesi i Prokurorisë Shkodër. Referuar kësaj shkrese, konstatohet se data e konceptimit të saj nga prokurori Çardaku është 28.12.2018, pra menjëherë me marrjen e vendimit për pushimit të procedimit penal. Në këtë kontekst, si dhe në kushtet kur rezultoi e provuar se viktimja e veprës penale ka marrë dënim për këtë vendim, pra se nuk i është mohuar e drejta për ushtrimin e ankimit ndaj këtij vendimi, Komisioni vlerëson se kjo rrethanë e njoftimit me vonesë të këtij vendimi nuk mund të ndikojë në vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorit Lazer Çardaku.

144.1 Ndërsa, sa i përket pretendimeve të tjera të ngritura nga denoncuesi, trupi gjykues çmon se ato kanë të bëjnë kryesisht me interpretimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm dhe, si të tilla, ato janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat.

145. Si përfundim, pas shqyrtimit në tërësi të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova për gjetje në lidhje me kriterin e vlerësimit në aspektin etiko - profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Lazer Çardaku.

Denoncimi i shtetasit I.D⁶²

146. Nga verifikimi i kësaj ankese duket se denoncuesi ka pretendime në lidhje me tërheqjen nga ankimi të bërë nga prokurori Lazer Çardaku – në cilësinë e prokurorit të Apelit – në lidhje me vendimin penal nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

146.1 Kështu, denoncuesi në ankesën e tij ka sqaruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me vendimin nr. ***, datë 26.6.2019, ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit A.S, për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, për shkak se nuk provohet që i pandehuri të këtë kryer këtë vepër penale për të cilën akuzohet dhe se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me nr. ***, datë 5.3.2021, për shkak të heqjes dorë nga prokurori Lazer Çardaku (në kundërshtim me ligjin).

⁶¹ Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 13.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 28.3.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶² Ankesa nr. *** prot., datë 20.5.2021.

147. Komisioni administroi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁶³ vendimin penal nr. *** të Gjykatës së Apelit Shkodër, që i përket të pandehurit A.S , si dhe procesverbalet gjyqësore të nxjerra nga sistemi ICMS. Pas verifikimit të këtij vendimi, sa i përket kësaj çështje penale, rezulton se:

147.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me vendimin nr. ***, datë 26.6.2019, ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të të pandehurit A.S , për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, për shkak se nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

147.2 Kundër këtij vendimi, në datën 1.7.2019, ka paraqitur ankim prokurori, i cili në përfundim ka kërkuar: *“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke e deklaruar fajtor të pandehurin A.S , për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit burgim, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal. Detyrimin e të pandehurit për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar shtetasit I.D”*.

147.3 Kundër këtij ankimi, në datën 10.7.2019, ka paraqitur apel-kundërshtues i pandehuri A.S , i cili në përfundim ka kërkuar: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”*.

147.4 Kundër vendimit të gjykatës, në datën 8.7.2019, ka paraqitur ankim edhe i dëmtuari/kallëzuesi I.D , i cili në përfundim të ankimit ka kërkuar: *“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke e deklaruar fajtor të pandehurin A.S për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës”... Detyrimin e të pandehurit për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar”*.

147.5 Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, në datën 5.3.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur mospranimin e ankesës të bërë nga prokurori dhe viktima ndaj vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

148. Rezulton se gjatë gjykimit në Apel, në seancë gjyqësore, prokurori Lazer Çardaku deklaroi heqjen dorë nga ankimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Në këto rrethana, bazuar në nenin 420, pika 1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale, Gjykata e Apelit ka argumentuar se në kushtet kur vetë prokurori ka hequr dorë nga ankimi, ky ankim nuk mund të merret në shqyrtim. Në vijim, lidhur me ankimin e paraqitur nga i dëmtuari/kallëzuesi, Gjykata e Apelit konstaton se gjenden në kushtet e nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale, pra të mospranimit të ankimit, për shkak se ligji procedural nuk i jep të drejtë viktimës të ankimojë vendimin e themelit, pasi interesat e saj në gjykim mbrohen nga organi i akuzës. Në vijim, gjykata ka bërë analizën ligjore, duke referuar dispozitat konkrete, në të cilat parashikohet e drejta e ankimit dhe, në veçanti, duke referuar nenin 422 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin përcaktohet se prokurori, i pandehuri dhe paditësi, dhe i padituri civil kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

149. Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të argumentojë/shpjegojë në mënyrë të detajuar mbi shkaqet/rrethanat/provat, të cilat e çuan në

⁶³ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 9.9.2024 dhe shkresa kthim përgjigjeje e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. *** prot., datë 27.9.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.9.2024).

vendimin për heqje dorë nga ankimi, për sa kohë në cilësinë e përfaqësuesit të akuzës ka pasur detyrimin për mbrojtjen e interesave të viktimës gjatë këtij gjykimi.

150. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka parashtruar se shtetasi I.D me të njëjtin objekt është ankuar edhe në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe se pas verifikimit të ankesës, bazuar në nenin 122, pika 5 e ligjit nr. 96/2019, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e kësaj ankese, ndër të tjera, me arsyetimin se: *“Prokurori Lazer Çardaku, në ndjekjen penale të çështjes me të pandehur z. A.S , akuzuar se ka kryer veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, si dhe në kërkesën e tij “për heqje dorë nga ankimi”, ka përmbushur funksionin e tij, duke iu referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Sipas parashikimeve të kësaj natyre për veprimtarinë vendimmarrëse të prokurorit, që kanë lidhje me vlerësimin e provave gjatë procesit gjyqësor dhe përfaqësimit në gjyq në emër të shtetit, janë objekt shqyrtimi e kontrolli gjyqësor nga ana e gjykatës dhe mbi bazën e mjeteve të ankimit shqyrtohen edhe në një gjykatë më të lartë”*⁶⁴.

150.1 Për sa më sipër, subjekti referon se verifikimi administrativ i bërë nga ILD-ja ndaj ankesës së shtetasit I.D hedh poshtë pretendimet e këtij të fundit dhe se prej tij, si përfaqësues i akuzës, është vepruar në përmbushje të ushtrimit të detyrës funksionale dhe zbatimit të ligjit procedural penal.

151. Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues çmon se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm e, për rrjedhojë, nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova për gjetje në lidhje me kriterin e vlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Lazer Çardaku.

Denoncimi i shtetasit A.M⁶⁵

152. Nga verifikimi i kësaj ankese duket se denoncuesi (viktimë e veprës penale) ankohet se prokurori pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, Lazer Çardaku, nuk ka ushtruar të drejtën e rekursit në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit P (A) D, edhe pse sipas tij vendimi i Gjykatës së Apelit kishte shkelje të rënda ligjore, duke hedhur dyshime se vendimi i prokurorit ka qenë i ndikuar dhe jo i zakonshëm.

152.1 Për sa më sipër, pretendohet se prokurori Çardaku ka kryer shkelje të rënda ligjore në dëm të viktimës së veprës penale, duke cenuar figurën e tij dhe besimin e qytetarëve te sistemi i drejtësisë.

153. Nga verifikimi i këtij denoncimi dhe dokumenteve të depozituara bashkëlidhur tij, duket se për ngjarjen e ndodhur në K, Lezhë, datë 26.6.2022, ku është kallëzuar shtetasi P (A) D se ka goditur me lopatë shtetasin A.M , Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2020, për veprat penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 22 e 76 të Kodit Penal, si dhe “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

⁶⁴ Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar praktikën e plotë të mbajtur nga ILD-ja lidhur me arkivimin e ankesës (shkresa nr. *** prot., datë 21.7.2022), si dhe parashtrimet e bëra prej tij në seancë gjyqësore.

⁶⁵ Ankesa nr. **** prot., datë 7.4.2023 (përpiluar nga mbrojtësja ligjore, av. M. K).

153.1 Bazuar në kërkesën e bërë nga prokurori i çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë⁶⁶, në datën 14.7.2022, ka vendosur caktimin e masës e sigurimit personal “Arrest me burg” ndaj shtetasit A.(P) D, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 22 e 76 të Kodit Penal, si dhe “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

153.2 Pas kërkesës së bërë nga personi nën hetim, A.D, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në datën 26.9.2022, ka vendosur⁶⁷ zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 14.7.2022, në caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, për të dyshuarin A(P)D, i dyshuar për veprat penale “Vrasja” e mbetur në tentativë dhe “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga nenet 76-22 e 277 të Kodit Penal.

153.3 Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokurori, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 23.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë – vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim A.D .

153.4 Pas shqyrtimit të këtij ankimi, Gjykata e Apelit Shkodër, në datën 10.11.2022, ka vendosur⁶⁸ lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 26.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

154. Rezulton se prokurori Çardaku ka qenë përfaqësuesi i Prokurorisë në gjykimin në apel të masës së sigurimit personal ndaj shtetasit A.D dhe se gjatë gjykimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 23.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë – vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj personit nën hetim A.D.

155. Gjithsesi, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë komentet/shpjegimet e tij shteruese për pretendimet e ngritura në këtë denoncim, si dhe të argumentojë mbi faktin e mosushtrimit të rekursit ndaj vendimit nr. ***, datë 10.11.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

156. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit në lidhje me kërkesat e bëra nga Komisioni për çështjen objekt denoncimi, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në ushtrim të detyrës funksionale si përfaqësues i akuzës, pas administrimit dhe studimit të vendimit nr. ***, datë 10.11.2022, të Gjykatës së Apelit Shkodër, prej tij nuk është ushtruar rekurs – pasi ka vlerësuar se ky vendim është bazuar në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe nuk kishte shkaqe që mund të përlligjinin rekursin. Kështu, subjekti ka evidentuar se sipas praktikës së Gjykatës së Lartë në rastin e rekruseve me lëndë të masave të sigurimit, shqyrtimi i tyre lidhet ngushtësisht me pretendime për shkelje të ligjit⁶⁹.

⁶⁶ Vendimi nr. ***, datë 14.7.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶⁷ Vendimi nr. ***, datë 26.9.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶⁸ Vendimi nr. ***, datë 10.11.2022, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

⁶⁹ Në prapësimet e tij, subjekti ka referuar disa vendimi të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

156.1 Në këtë kontekst, subjekti argumenton se vlerësimi i tij si përfaqësues i akuzës në lidhje me çështjen konkrete, për të cilën është ankuar shtetasi A.M , është një qëndrim i drejtë, procedural - ligjor, i mbështetur në analizën e hollësishme e të argumentuar të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, si një vendim i drejtë e i bazuar në ligj.

156.2 Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, subjekti referoi faktin se shtetasi A.M në lidhje me këtë çështje është ankuar edhe në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe se pas verifikimit të ankesës, bazuar në nenin 122, pika 5 e ligjit nr. 96/2019, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e kësaj ankese⁷⁰.

157. Pas shqyrtimit në tërësi të kësaj ankese dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues çmon se duken bindëse dhe në nivel ligjor shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me çështjen objekt denoncimi dhe qëndrimin e mbajtur prej tij si përfaqësues i organit të akuzës, dhe se nuk ka indicie për të provuar pretendimet e denoncuesit për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe/apo figurën e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Lazer Çardaku.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

158. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze, apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

159. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

Vlerësimi tërësor i çështjes

160. Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, pasi: (i) në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka kryer deklaram të rremë për vlerën e blerjes së apartamentit + shtesës anësore në Shkodër, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të hetimit, duke mos deklaruar përdorimin e një pasurie të paluajtshme – pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016; (iii) nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* përdorimin prej tij apo personave të lidhur të pasurisë së llojit automjet, në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016; (iv) ka përdorur një automjet në pronësi të një shtetasi tjetër për një periudhë të gjatë kohore pa kundërshtëpërbllim dhe pa dokumentacion justifikues ligjor.

⁷⁰ Gjatë seancës dëgjimore, subjekti depozitoi si prova të reja dokumentet: (i) shkresën e ILD-së me nr. *** prot., datë 6.11.2024, “Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas shqyrtimit fillestar”; (ii) vendimin e ILD-së me nr. *** prot., datë 6.11.2024, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga av. M.K”.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të saj, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Gjithashtu, në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 8.11.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKSI NR. 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	1992-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	26.01.2017
A) PASURI	2,600,000	0	229,042	324,361	256,052	-729,570	-69,429	225,379	-16,839	-49,325	551,855	-11,817	1,165,682	501,201	-298,576
Shtëpi banimi me sip.95m2, tre kate, e ndërtuar në vitin 1940 në fshatin B Bashkia Shkodër, e trashëguar dhe e paregjistruar. Në bashkëpronësi me prindërit, vëllain, motrat.	0														
Tokë bujqësore (arë) me sip. 2 dynym e ndodhur në fshatin B Bashkia Shkodër e trashëguar, e paregjistruar. Në bashkëpronësi me prindërit dhe vëllain.	0														
Apartament banimi 1+1, pallati i ish nd/bujqësore O fshati O me sipërfaqe 48.5 m2 pronësi e fituar me privatizim.	200,000														
Apartament me sip. 73 m2 me adresë L. "****" Shkodër, blerë në 23.08.1999, në vlerën 200.000 lekë. Kjo pronë është rivlerësuar në shumën 4.036.900 lekë. Zotërimi 100% me b/shorten.	2,400,000														
Truall me sip. 22.9 m2 + ndërtesë me sip. 22.9 m2, me adresë L. "****" Shkodër, e regjistruar me leje legalizimi, në vlerën 670.764 lekë. Zotërimi 100% me b/shorten.															
Automjeti i markës "****", tip "****", me targa AA***	0								150,000						
Automjeti i markës "****", tip "****", me targa AA***	0												137,650		
Automjeti i markës "****", tip "****", me targa AA***	0										559,360				
Autoveturë tip "****", me targa AA***, në emër të B. Ç	0												418,650		
Ndryshim likuiditeti	0	0	229,042	324,361	256,052	-729,570	-69,429	225,379	-166,839	-49,325	-7,505	-11,817	609,382	501,201	-298,576
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) PASURI NETO (A-B)	2,600,000	0	229,042	324,361	256,052	-729,570	-69,429	225,379	-16,839	-49,325	551,855	-11,817	1,165,682	501,201	-298,576
D) TË ARDHURA	3,977,756	1,001,585	1,274,558	1,099,685	1,027,917	1,274,025	1,244,096	1,437,557	1,270,513	1,259,788	1,596,860	1,336,789	2,747,209	2,267,471	199,874
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	3,855,836	1,001,585	1,074,558	1,099,685	1,027,917	1,178,336	1,110,048	1,288,965	1,128,626	1,118,546	1,133,829	1,282,218	1,308,429	1,204,459	109,791
Të ardhura nga paga / pagesa e papunësisë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	121,920					86,714	134,048	148,592	141,887	141,242	163,031	54,571	219,746	329,620	28,914
Të ardhura nga paga E. Ç.	0												58,608	234,432	19,536
Të ardhura nga paga B. Ç	0												391,001	498,960	41,633
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës "****", tip "****", me targa AA***	0										300,000				
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës "****", tip "****", me targa AA***	0												150,000		
Të ardhurat nga shitje e automjetit të markës "****", tip "****", me targa AA***	0												619,425		
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në Raiffeisen Bank						8,975									
Të ardhura nga shitja e apartament banimi 1+1, pallati i ish nd/bujqësore O, Shkodër.	0		200,000												
E) SHPENZIME	2,680,799	375,456	480,028	482,978	623,876	1,161,535	608,371	623,473	674,236	692,579	651,198	1,030,134	1,026,071	1,021,891	78,364
Shpenzime jetike	2,680,799	375,456	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368	78,364
Shpenzime arsimit për djalin e subjektit E.Ç	0						21,200	48,500	67,500	53,801	13,801	13,801	45,000	45,000	
Shpenzime arsimit për djalin e subjektit B.Ç	0		41,800	44,750	44,750	51,000	16,000	16,000	16,000	16,000	59,280	59,280			
Shpenzime udhëtime jashtë vendit	0				32,646	64,055	24,691	12,493	44,256	58,682	14,021	77,061	83,967	36,523	
Shpenzime për riparimin në apartamentin 73 m2 në Shkodër						500,000									
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1,303,043	626,129	565,488	292,346	147,989	842,060	705,154	588,705	613,116	616,533	393,807	318,473	555,457	744,379	420,086